

AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË
ACADEMY OF SCIENCES OF ALBANIA

Raport VJETOR
2011
ANNUAL Report



Tiranë, 2012

Përgatitur nga:
Kryesia e Akademisë së Shkencave e Shqipërisë
Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike
Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike
Nën drejtimin e:
Akad. Prof. Dr. Salvatore Bushati

Prepared by:
Presidency of Academy of Sciences of Albania
Section of Natural and Technical Sciences
Section of Albanological and Social Sciences

Përkthimi në anglisht / *Translated in English*
by Esmeralda Aliaj

Kompjuterizimi / *Computer setting:*
Enkelejda Misha

Address:
Akademia e Shkencave e Shqipërisë
Academy of Sciences of Albania
Sheshi Fan S. Noli, Tirana, Albania
Tel: 00355 4 2259657
Tel/Fax: 00355 4 2227476

Shtypur në shtypshkronjën "Kristalina KH"
Tiranë, 2012



Acad. Prof. Dr. **Gudar Beqiraj**
President of ASA

I nderuar lexues,

Analiza e veprimtarisë vjetore të institucioneve të sistemit të shkencës dhe teknologjisë, nuk duhet parë si një proces thjesht i zakonshëm i raportimit të punës së bërë, por si një element i rëndësishëm për një analizë të thellë të arritjeve në kërkimin shkencor e ndikimin e tyre në zhvillimin teknologjik e inovativ e refleksion mbi atë çka duhet bërë në të ardhmen për përmbushjen e misionit.

Akademia e Shkencave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik e Inovacioneve, ka synuar arritjen e standardeve europiane, në përmbushjen e objektivave për integrim në fushën e shkencës.

Në këtë kuadër, veprimtaritë kryesore janë përqendruar në krijimin e një infrastrukture të përshtatshme për fuqizimin e forcimit e kapaciteteve dhe rritjen e rolit të saj në zhvillimin e vendit; bashkëpunimin me institucionet qeveritare në identifikimin e problematikave për angazhimin e ASH-së në realizimin e objektivave të Qeverisë; këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse; bashkëpunimin me institucionet kërkimore dhe mësimore brenda dhe jashtë vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë; propozimin e fushave të reja të kërkimit e studimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik e social të vendit; botimin e organeve periodike dhe të veprave të tjera me nivel të lartë shkencor; organizimin e kongreseve, konferencave shkencore dhe problemore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare; promovimin dhe mbështetjen e ekselencës e kërkuesve të rinj në shkencë në shkallë kombëtare, për të realizuar nivele të larta kërkimi dhe për të krijuar e mbështetur strukturat e saj të përfaqësimit; dhënien e çmimeve shkencore, etj.

Vëmendje i është kushtuar rekomandimeve të analizave të BE-së, lidhur me zhvillimet e Sh&T në vendet e Ballkanit Perëndimor, gjendjes së kërkimit në Shqipëri dhe masave për intensifikimin e punës për

Dear Reader,

The analysis of the annual activity of the institutions of Science and Technology system should not be seen simply as a routine process of the survey for the work done, but as an important element for a profound analysis of the achievements in the scientific research and their impact on the innovative technological development and also the reflection of what should be done in the future to fulfill the mission they have.

The Academy of Sciences, to fulfill its mission in accordance with the National Strategy of Research, Technological Development and Innovation, aimed at achieving European standards, in fulfilling the objectives for the integration in the field of science. In this context, the main activities are focused on the creation of a suitable infrastructure for the strengthening and the fortifying capacities, to increase its role in the development of the country; the cooperation with the governmental institutions to identify the problems for the AS commitment in the realization of the objectives of the Government; for the advice and necessary expertise for policy and decision-making institutions; the cooperation with the research and teaching institutions, in the country and abroad, to carry out studies in various fields of science and technology; the proposing of new areas of research and study, in accordance with needs of economic and social development of the country; the publication of periodic bodies and other works of high scientific level; the organization of the congresses and the scientific and problematic conferences nationally and internationally; the promotion and the support of the excellence of young researchers in science nationally to achieve high levels of research and to establish and to support its structures of representation; the bestowal of the scientific prizes, etc.

An attention was paid even to the recommendations of the analysis of the EU, regarding the development of ST in the Western Balkan countries, the state of research in Albania and the measures for the intensification of

zbutjen e dobësive në Sh&T, të tilla si: (i) mbizotërimi i sektorit publik në Sh&T mbi atë privat; (ii) mungesa e integritit ndërmjet agjendave të kërkimit dhe politikave të tjera; (iii) thithja e dobët e fondeve; (iv) përfshirja e pamjaftueshme në Sh&T e sektorit privat apo mungesa e promovimit të arritjeve të shkencës dhe teknologjisë; (v) mungesa e mekanizmave nxitës për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar; (vi) zhvillimi dhe aplikimi i pamjaftueshëm i strategjive dhe ligjeve ekzistuese në Sh&T.

Për këtë problematikë, Akademia ka pasur parasysh Strategjinë e KZhTI e të strategjive të tjera të Qeverisë, studimin e rekomandimeve të ALLEA-s, IAP-së, ICSU-së, UNESCO-s, si dhe të institucioneve ndërkombëtare, brenda mundësive dhe kushteve reale të vendit tonë, të zhvillimit ekonomik të vendit në përgjithësi.

Akademia e Shkencave të Shqipërisë në fokusin e saj ka orientimin e kërkimeve në problematikën shkencore me rëndësi kombëtare, për ndriçimin e traditave dhe vlerave të kombit në fushë të gjuhës, historisë dhe të kulturës, vlera që na integrojnë në bashkësinë europiane me dinjitet dhe me identitetin tonë si popull.

Veprimtaritë kërkimore **në fushën e albanologjisë**, u zhvilluan me përparësi në fushën e gjuhësisë, historisë dhe trashëgimisë së kulturës shpirtërore dhe materiale. E rëndësishme është shtrirja e tri fushave të lartpërmendura të kërkimit shkencor në mbarë hapësirat shqiptare, pra për bashkëpërfshirjen potenciale të studiuesve shqiptarë dhe të huaj në trajtimin e këtyre problematikave të vlefshme dhe për formimin e profesionistëve të rinj.

Në fushën e gjuhësisë, studimet u përqëndruan në problematikën e njësimin të gjuhës shqipe, për zbatimin e normës dhe përsosjen e standardit, ndërsa në fushën e historisë, synohet një vlerësim objektiv i proceseve historike për të shmangur shtrembërimet ideologjike të së kaluarës. Në fushën e trashëgimisë kulturore u zhvilluan veprimtari në lidhje me identifikimin dhe dokumentimin e trashëgimisë materiale dhe gojore në mbarë trevat shqiptare në shekuj. Botimet në gjuhën shqipe dhe veçanërisht në gjuhë të huaja, rritën bashkëpunimin ndërmjet kërkuesve shqiptarë dhe të huaj sipas fushave, duke patur parasysh ngjashmëritë dhe dallimet në rajon. Të gjitha këto kontribuojnë në synimin madhor për formimin e një shoqërie civile cilësore, me mentalitet demokratik, të aftë për të përballuar sfidat e integritit të Shqipërisë në familjen e madhe europiane, rritjen e cilësisë së jetës etj.

Përparësia në shkencat natyrore dhe teknike u orientuan në fusha të tilla si: teknologjitë e informimit e komunikimit; shëndetësia dhe shërbimi parësor; rregullimi i regjimit ujor në liqene, lumenj e laguna;

the work to mitigate the weaknesses in S & T, such as: (i) the prevalence of the public sector in S & T on the one private; (ii) the lack of integration between the agendas of research and other policies; (iii) the poor absorption of the funds; (iv) the insufficient inclusion in S & T of the private sector or the lack of promotion of the achievements of science and technology; (v) the lack of incentive mechanisms to enhance the international cooperation; (vi) the insufficient development and application of existing laws and strategies in S & T.

For this problem, the Academy has taken into consideration the Strategy of RDTI and the other Government strategies, the study of the recommendations of ALLEA, IAP, ICSU, UNESCO, and of the other international institutions within the real possibilities and the real conditions of our country, and its economic development in general.

The Academy of Sciences of Albania is focused on the direction of the research in the scientific issues of national importance for the light of traditions and identity values of the nation in the field of language, history and culture, values that integrate us into the European community with dignity and with our identity as a nation.

The research activities in the field of Albanology were developed with a priority in the field of linguistics, history and heritage of spiritual and material culture. What is important is the extension of the above three areas of scientific research across Albanian territories, thus for the potential inclusion of the Albanian and foreign researchers in the treatment of these issues and the contribution to the formation of these young professionals.

In the field of linguistics, the studies were focused on the problems of the unification of the Albanian language, for the implementation of the norm and the improvement of the standard rate, while in the field of history, it is aimed an objective assessment of historical processes to avoid the ideological distortions of the past. While in the field of the cultural heritage, some activities took place for the identification and the documentation of the material and oral heritage across the Albanian territories for centuries. The publications in Albanian, and especially in foreign languages, increased the cooperation between Albanian and foreign researchers by the fields, given the similarities and differences in the region. All these contributed to a major goal to form a qualitative civil society, with democratic mentality, able to withstand the challenges of the integration of Albania into the great European family, the improvement of the quality of life etc.

While the priorities in natural and technical sciences were oriented in such areas as: the information and communication technologies, health and primary service; the regulation of water regime in lakes, rivers

shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme; vlerësimi, ruajtja dhe rehabilitimi i ekosistemeve natyrore; biodiversiteti dhe cilësia e ushqimit; transferimi dhe aplikimi i teknologjive të reja në fusha të ndryshme e me përparësi ato të trashëgimisë kulturore, etj.

Domosdoshmëria e kërkimit shkencor për zhvillimin e vendit e në arritjen e treguesve të anëtarësimit në Europë, kërkon rritjen e kapaciteteve këshilluese të ASH-së, ndaj organeve politikbërëse e vendimmarrëse dhe të shoqërisë civile. Kjo gjatë vitit 2011 u realizua me mbështetjen e Projektit të Rrjetit të Akademive të Botës, në përputhje edhe me prioritetet e InterPanelit të Akademive të Shkencave, Rrjetit të Akademive të Shkencave të Europës (ALLEA).

Rritja e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, realizimi i marrëveshjeve e protokolleve me institucione kërkimore shkencore e universitare si dhe paraqitja dinjitoze e ASH-së në takime ndërkombëtare, kanë qenë në fokus të veprimtarisë së saj. Këto i kanë shërbyer transferimit të eksperiencave europiane e ndërkombëtare në Shqipëri në të gjitha fushat e zhvillimit.

Përpjekje të konsiderueshme janë bërë në drejtim të pjesëmarrjes së ASH-së në Programet Kuadër të BE-së ose në programe të tjera me karakter kërkimor, ku Akademia përfaqësohet si koordinator ose jep kontribut në nivel ekspertësh.

Objektiv i veçantë ishte edhe këtë vit bashkëpunimi me vende të tjera, me synim krijimin e përmirësimin e lidhjeve e të marrëdhënive të saj në botë nëpërmjet rritjes cilësore të bashkëpunimeve në fusha të kërkimit shkencor në shkencat shoqërore e natyrore-teknike. ASH ka synuar një pjesëmarrje aktive në partneritet në pesë fusha të iniciativës së Programit të Hapësirës Europiane të Kërkimit "ERA", që konsistojnë në: (i) bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë dhe teknologji; (ii) intensifikimin e partneritetit në kërkim; (iii) transferimin e teknologjive; (iv) kërkimet në infrastrukturë; (v) zhvillimet më të reja në shkencë etj.

Gjatë vitit 2011, Akademia ka realizuar bashkëpunime dhe ka marrë pjesë aktive në disa organizma të rëndësishëm në nivel europian e botëror ku ajo jep kontributin e saj në lidhje me prurjet në kërkimin shkencor në Shqipëri. ASHSh ka krijuar një sërë marrëveshjesh e lidhjesh me institucione ndërkombëtare shkencore me përfshirjen e ASHSh-së e të institucioneve të tjera shkencore e arsimore në Shqipëri me impakt në K-Zh.

Nëpërmjet veprimtarive të saj, ASHSh ka pasur në fokusin e saj forcimin e ndërveprimit ndërmjet shkencës dhe biznesit, për kontributet e këtij të fundit drejtpërdrejt në K-Zh duke e konsideruar si një motor të zhvillimit: zbatimin e të rejave shkencore, teknologjike e inovative në zhvillimin e biznesit në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) e më gjërë.

and lagoons; the use of renewable energy; evaluation, conservation and rehabilitation of natural ecosystems; biodiversity and food quality; transfer and application of new technologies in various areas of priority and the ones of cultural heritage, etc.

The need for the development of the country and of the scientific research in the achievement of the indicators of the membership in Europe, sought to increase the advisory capacities of AS, against the decision and policy-making organs of civil society. This was accomplished in 2011 with the support of the Network Project of the World Academies, in accordance with the priorities of the InterPanel of the Academies of Sciences, Network of Science Academies of Europe (ALLEA).

The increase of the national and international cooperation, the implementation of the agreements and protocols with scientific and university research institutions as well as the dignified appearance of AS in international meetings, have been the focus of its activity. These have served to transfer the European and the international experiences in Albania in all fields of development.

Considerable efforts are made towards the participation of AS in the EU Framework Programmes or other programs with research character, where the Academy is represented as a coordinator or contributes to the expert level.

A specific target was the cooperation with other countries, with the aim of creating improved links, its relationship in the world through the increased quality of collaborations in fields of scientific research in social and natural -technical sciences. AS has aimed at an active involvement in the partnership in 5 areas of initiative of the Programme of the European Research Area, "ERA", which consist in: (i) international cooperation in science and technology; (ii) intensification of partnership in research; (iii) the transfer of technologies; (iv) researches in infrastructure; (v) new developments in science, etc.

During 2011, the Academy has conducted cooperations and is an active participant in several important organizations in European and world level where it gives its contribution in relation to the flows for the scientific research in Albania. ASA has created a series of agreements and links with international scientific institutions with the involvement of ASA and of other scientific and educative institutions in Albania with an impact on R-D.

Through its activities, ASA has had in its focus the strengthening of the interaction between science and business, for the latter contributions directly to the R-D viewing it as an engine of development: the application of the scientific, technological and innovative product in the development of the business in Small and Medium Enterprises (SME) and beyond.

Veprimtaritë e AShSh-së janë zhvilluar nëpërmjet projekteve, konferencave e botimeve, monografive e periodikëve, brenda e jashtë vendit, ku janë përfshirë projekte të Këshillit të Ministrave, ato të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZh-AKTI), në kuadër të Protokolleve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalëshe (MASH dhe AKTI), si dhe programeve të tjera të mbështetura nga Akademitë e Shkencave dhe organizma europianë apo ndërkombëtare, programet FP7, UNESCO, WBC-INCO.NET etj. Projektet në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, sollën prurje të reja gjatë vitit 2011.

Rezultatet e punës shkencore të akademikëve brenda dhe jashtë vendit janë paraqitur në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në botime shkencore.

Një vend të veçantë në veprimtaritë e AShSh-së pati edhe bashkëpunimi me shkollat e larta. Akademikët në vazhdimësi japin kontribut të konsiderueshëm në mësimdhënie, në udhëheqje doktoratash, në hartimin e teksteve mësimore, të kurrikulave etj.

Për vitin 2012 përparësitë e ASh-së do të përqendrohen sipas problematikave në disa fusha me përparësi: arsimit dhe shkencës; uji dhe energjia; emergjenca civile; bujqësia dhe ushqimi; bioteknologjitë e biosigurisë; biodiversiteti; shëndetësia dhe cilësia e jetës; teknologjitë e informacionit dhe komunikimit; mjedisi; gjuhësia; historia; trashëgimia kulturore; sociologjia; ekonomia; financa dhe problemet demografike; reformimi dhe funksionimi i Këshillit Ndërkombëtar Kombëtar të Gjuhës Shqipe; bashkëpunimi me universitetet e vendit (shtetërore e private) për forcimin e lidhjeve të ndërsjella ndërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, gjithmonë për një zhvillimin të qëndrueshëm të vendit.

Kërkuesit e rinj dhe edukimi në shkencë me grupmosha të ndryshme, do të përbëjë një përparësi të AShSh-së edhe në të ardhmen, ku do të përfshihet bashkëpunimi me aktorë të mësimdhënies në të gjitha nivelet, nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtari të përbashkëta (projekte, konferenca, seminare, tryeza të përbashkëta etj.).

Gjithashtu, ka rëndësi lidhja dhe zbatimi i produktit të kërkimit në biznes, në zbatim të konventës së Lisbonës, sipas së cilës reforma e KZHTI do të synojë reformimin e sistemit financiar drejt mekanizmave të ekonomisë së tregut.

Rritja e kapaciteteve të kërkimit shkencor në biznes do të jetë nxitës i investimeve më të efektshme në sektorin privat.

Kontributi i biznesit në kërkim është sfida e zhvillimit të sigurt e të shëndetshëm të shkencës, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në Shqipëri. Promovimi i rolit jetik të sektorit privat në zhvillimin e KZHTI në

ASA activities are developed through projects, conferences and publications, monographs and periodicals, within and abroad, involving projects of the Council of Ministers, those supported by the National Programme for Research and Development (NPRD-ARTI), in the framework of Protocols of the Scientific and Technological Bilateral Cooperation (MES and ACT) and other programs supported by the Academies of Sciences and European or international organizations and programs like FP7, UNESCO, WBC-INCO.NET, etc. Projects under the Agreement of the Research-Scientific and Artistic Cooperation between the Albanian Academy of Sciences and Academy of Sciences and Arts of Kosovo brought new arrivals during 2011.

The results of the scientific work of academics within and abroad are presented in national and international conferences and in scientific publications.

A special place in the activities of ASA had even the cooperation with the universities; academics consistently make a significant contribution in teaching, in leadership doctorates, in the design of textbooks, curricula, etc.

This year, the AS priorities will focus regarding to some problems in some priority areas in the fields of science and education, water, energy, civil emergencies, food and agriculture, biotechnology and biosecurity, biodiversity, health and quality of life, information and communication technologies of the environment, linguistics, history, cultural heritage, sociology, economics, finance and demographic problems, civil emergencies, the reform and functioning of the national academic Council of the Albanian language, the connection with local universities (state and private) to strengthen bilateral links between teaching and scientific research, always for a sustainable development of the country.

Young researchers and the education in science with different age groups will be a priority for ASA in the future, where it will be included even the collaboration with teaching actors at all levels, through participation in joint activities (projects, conferences, seminars, common tables, etc.).

The relation and the implementation of the research product in business, in the implementation of the Lisbon Convention, under which the RDTI reform will aim at reforming the financial system towards the market economy mechanisms.

- The increase of the capacities of the scientific research in the business will be the promoter of the most rentable investments in the private sector.

The contribution of the business in research is the challenge of the safe and sound development of science, the technological development and innovation in Albania. The promotion of the vital role of the private

vend, duhet kuptuar si thelbi i inovacionit. Një bashkërendim i mirë i politikave qeveritare me strategjitë e biznesit është vendimtar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për të gjeneruar risi.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet *mosdiskriminimit dhe barazisë gjinore*, një dukuri për të cilën duhet shumë punë dhe përfshirje sa më e gjerë e shoqërisë civile.

AShSh e sheh të rëndësishme dhënien e kontributeve në përmirësime të mëtejshme të legjislacionit për kërkimin shkencor e menaxhimin e tij me efikasitet.

Për AShSh-në do të jetë e rëndësishme vendosja e një dialogu konstruktiv e të vazhdueshëm me organizmat qeveritarë për rritjen graduale të fondeve të caktuara për kërkim e zhvillim, në mënyrë që edhe në këtë tregues vendi të ecë krahas me vendet të tjera të Bashkimit Europian ku do të aderojmë së shpejti, për miradministrimin e rritjen e autonomisë së projekteve nga burokracia e sistemit financiar, duke iu përqasur sa më tepër praktikave të Bashkimit Europian. Politikat e K-Zh duhet të ndryshojnë nga "politikat e sigurimit të fondeve", te politikat e "stimulimit për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin".

Përparësi për vitin 2012 do të mbetet edhe botimi i veprave me vlera të veçanta shkencore të akademikëve dhe të studiuesve më në zë që kryejnë veprimtari brenda e jashtë vendit.

Me objektivat përparësorë, Akademia e Shkencave synon arritje në një nga atributet kryesore të saj: prestigjin e lartë të merituar në komunitetin shkencor, shoqërinë civile e më gjerë, për të qenë forcë lëvizëse e për të luajtur një rol themelor në nxitjen e zhvillimit të vendit në të gjitha drejtimet, me synimin kryesor kërkimin shkencor (për vënien në jetë të SKZHTI), për një cilësi të lartë në shoqërinë shqiptare, në institucionet politikbërëse e vendimarrëse si edhe në shoqërinë civile, biznesin vendës, të huaj etj.

Faleminderit!

sector in the development of RDTI in the country should be understood as a genius of innovation. A better coordination of governmental policies with the business strategies is crucial in the creation of a favorable environment to generate novation.

A special attention will be paid to the non-discrimination and gender equality, a phenomenon for which it is needed hard work and more extensive involvement of civil society.

ASA sees as significant the contributions for further improvements in the legislation for the scientific research and its efficient management.

For ASA it will be important to establish a continuous and constructive dialogue with governmental bodies to gradually increase the specific funds for research and development, so that even for this indicator, the country will go alongside with the other countries of the European Union, where we will adhere soon, for the well management and the increase of the autonomy of the projects from the bureaucracy of the financial system, by approximating more to the practices of the European Union. RD policies should change from "insurance policies of the funds" to the policies of "incentives for science, technology and innovation".

Priority for 2012 will remain even the publication of special works of scientific value of the most prominent Academics and researchers who perform activities within and abroad.

With its priorities, the Academy of Sciences aims an achievement in one of its main attributes, high-deserved prestige in the scientific community, civil society and beyond, to be a movement force, where it should play a fundamental role to stimulate the development of the country in all directions; with a priority in the scientific research (for the implementation of NSRDTI), for a high quality in the Albanian society, the policy-and decision-making institutions and civil society, local and foreign businesses etc.

Thank you!

PJESA E PARË

Veprimtaritë Kryesore të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë gjatë vitit 2011

Gjatë vitit 2011 në veprimtaritë e saj, AShSh ka synuar realizimin e funksioneve kryesore të saj në disa drejtime kryesore si në:

- bashkëpunimin me institucionet qeveritare në identifikimin e problematikave për angazhimin e ASh-së në realizimin e objektivave të Qeverisë, me pjesëmarrje në këshilla, grupe *ad hoc*, borde, etj;
- këshillimin dhe ekspertizën e nevojshme për institucionet politikëbërëse dhe vendimmarrëse;
- bashkëpunimin me institucionet kërkimore dhe mësimore, brenda dhe jashtë vendit, për kryerjen e studimeve në fusha të ndryshme të shkencës e teknologjisë, për hartimin e programeve kombëtare e dypalëshe, ekspertizave dhe monitorimeve të ndryshme në shkallë vendi etj;
- evidentimin e nxitjen e mundësive të aplikimit të produktit shkencor në praktikat prodhuese, koordinimin për vënien në zbatim dhe platformat për zhvillimin e teknologjive të reja;
- propozimin e fushave të reja të kërkimit e studimit, në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik e social të vendit;
- botimin e organeve periodike dhe veprave të tjera me nivel të lartë shkencor;
- organizimin e kongreseve dhe konferencave shkencore në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, mbi problematikat e fushave përparësore të zhvillimit të përgjithshëm të vendit (reformë shëndetësore, reformë e menaxhimit në mbarështrimin e sistemit pyjor, etj.);
- promovimin dhe mbështetjen e *ekselencës*, të kërkuesve të rinj në shkencë në shkallë kombëtare për të realizuar nivele të larta kërkimi dhe për të krijuar e mbështetur strukturat e saj të përfaqësimit;
- krijimin e një infrastrukture të përshtatshme të teknologjive të informacionit me standarde të kohës e në përputhje me strukturën e kërkuar për shpërndarjen e informacionit shkencor elektronik, veprimtari e Bibliotekës Shkencore të AShSh-së;
- krijimin e strukturave të reja për bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë me akademitë e tjera, në rajon e më gjerë;

Synimi i vazhdueshëm i ASh-së edhe këtë vit ka qenë zbutja e treguesve negativë në Shqipëri të tillë si:

- (i) mbizotërimi i sektorit publik mbi atë privat dhe

FIRST PART

Main activities of the Academy of Sciences of Albania for 2011

During the activities covering the period 2011, the ASA aimed at accomplishing in its activity its main functions in some general directions:

- the cooperating with government institutions to identify problems and to engage the AS in fulfilling the objectives of the Government, with the participation in the councils, ad-hoc groups, boarding groups, etc.
 - the advising and offering the appropriate expertise necessary for policy-making and decision-making institutions;
 - the cooperating with research and educational institutions, inside and outside the country, to conduct studies in different fields of science and technology; for the compilation of the national and bilateral programs, of the expertise and the different monitoring nationwide, etc;
 - the promotion and the coordination for the possibilities of the application of the scientific product in the productive practices, the appliance and platforms for the development of new technologies;
 - the proposal of new fields of research and study according to needs of the economic and social development of the country;
 - the publishing of periodicals and other works of high scientific level;
 - the organizing of scientific and problem congresses and conferences at national and international level in precedent fields of the general development of the country (health reform, reform of management in the expansion of the forest system.);
 - promoting and supporting excellent young researchers in science at the national level, in order to achieve high levels of research and to set up and support its structures of representation;
 - the creation of a proper infrastructure, of the information technologies with modern standards, according to the demanded structure for the delivering of the scientific and electronic information, activity of the scientific Library ASA;
 - the creation of the new structures for the international cooperation in science and with the other academies, in the region and nationwide;
- The constant aim of AS, even this year has been the softening of the negative indices in Albania such as:
- (i) the domination of the public sector over the private

përfshirja e pamjaftueshme e këtij të fundit në shkencë dhe teknologji (Sh&T) edhe si pasojë e marketimit të dobët nga institucionet për kërkim e zhvillim (K-Zh) mbi arritjet e tyre të shkencës dhe teknologjisë; (ii) mungesa e harmonizimit ndërmjet agjendave të kërkimit dhe politikave të tjera; (iii) mungesa e fondeve që duhen për K-Zh; (iv) mungesa e mekanizmave nxitës për rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar; (v) mosnjohja, zhvillimi dhe aplikimi i pamjaftueshëm i strategjive dhe ligjeve në Sh&T.

Vlerësimi i zhvillimeve dinamike të veprimtarisë duke iu referuar krahasimit të treguesve të arritur, bazuar në "Manualin e Fraskatit" (sipas pesë grupeve të treguesve të lidhur me: aktivitetin kërkimor bazë: aplikativ apo eksperimental; fushat e kërkimit; personelin, shpenzimet), evidenton arritje mjaft pozitive krahasuar me ato të një viti më parë. Përcaktimi i këtyre treguesve cilësorë dhe sasiorë në ASH, tashmë zbatohet për të bërë më të dukshme produktet e saj të K-Zh dhe vetë rolin që ato duhet të luajnë në zhvillimin ekonomik e social të vendit.

Treguesit e mëposhtëm përbëjnë rezultatet e ASH-së të arritura në vitin 2011.

Stafi akademik sot përbëhet nga 26 Akademikë, (3 të përhershëm), 13 Akademikë të asociuar dhe 2 Akademikë në politikë, të shpërndarë sipas fushave të kërkimit, si në diagramën e mëposhtme:

one in Science and Technology and the inadequate inclusion in S&T of the private sector as a result of the low marketing from the institutions of Research and Development, for their achievements of science and technology; (ii) The lack of harmonization between the agendas of research and other policies; (iii) lack of funds needed for the R-D; (iv) lack of simulating mechanisms for the increase of the international cooperation; (v) ignorance, development and insufficient application of the strategies and laws in S&T.

The valuation of the dynamical developments of the activity, referred to the comparison of the indices achieved with the previous years, based on the "Manual of Fraskat" (according to five indices groups related to: the basic research activity: applicative or experimental; the fields of research; the staff: the expenditure) make obvious quite positive achievements compared to those of a previous year. The determination of these qualitative and quantitative indices in AS, is already applied to make evident its products of R-D and its role that they have to perform in the economic and social development of the country.

The following indices are the results of the ASA reached in 2011.

Nowadays, the Academic Staff consists of 26 Academics (3 permanent) and 13 Associated Academics and 2 Academics in Politics, spread according to the fields of research, as in the following diagram:




Fig. 1. Përbërja e stafit akademik të ASH sipas fushave në vitin 2011
The structure of the academic staff of AS according to the research fields in 2011

Siç shihet, stafi akademik në vitin 2011 mbizotërohet nga përfaqësuesit e shkencave shoqërore e humane (17); më pas vijnë shkencat inxhinierike (8); ato natyrës (7) dhe shkencat e jetës (7).

Një tregues i përdorur nga institucionet ndërkombëtare është mosha e stafit akademik. Në grafikun e mëposhtëm jepet mosha e Akademikëve dhe e Akademikëve të asociuar në vitin 2011, krahasuar edhe me atë të vitit 2010.

As it can be seen, the academic staff is dominated by those of the social and humanitarian sciences (17); after that come the engineering sciences (8); those of nature (7) and the life sciences (7).

One indices used by the international institutions is the age of the academic staff. In the following graphic it is given the age of the Academics and of the Associated Academics in 2011, compared to the previous one in 2010.




Fig. 2. Stafi akademik sipas klasave të moshës në 2011 krahasuar me 2010
The academic staff according to the age group in 2011 compared to 2010

Mbizotërimi i klasave të moshës së madhe, ka një vlerë komplekse dhe konsiderohet normal për rolin dhe misionin e AShSh-së. Megjithatë, është synuar për uljen e moshës mesatare të klasës mbi 65 vjeç dhe ka përmirësime gjatë vitit 2011. Kështu gjatë 2011-ës, është synuar të rekrutohen në gjirin e akademikëve kërkues me vlera, me moshë relativisht të re. Për këtë qëllim, AShSh në përputhje edhe me nismat e akademive të botës, po përpunon strategji të reja për afrimin dhe mbështetjen e kërkuesve të rinj në shkencë çka do të vazhdojë të jetë përparësi për Akademinë edhe në vitin 2012 e në vazhdim.

Nga grafiku vihet re një përmirësim i strukturës krahasuar me vitin 2010, moshë 45-54 vjeç është rritur nga 4 në 5 (me 12,2%), dhe po kështu ajo 55-64 vjeçare nga 14 në 18 (me 43,9%), ndërkohë që është ulur numri i personave me moshë mbi 65 vjeçare nga 21 në 18 (me 43,9%).

Treguesit ekonomikë të AShSh-së gjatë vitit 2011 kanë pasur një shifër të planifikuar 81.5 milion lekë dhe janë realizuar 75.34 milion lekë. Këta tregues, në skemë rezultojnë si më poshtë:

Prevalence of old age classes is of a complex value and is considered normal for the role and mission of ASA, though it is aimed for the lowering of the middle-aged of the class over 65 years old and during 2011 it has some improvements. So during 2011, it is aimed at recruiting among academics valuable researchers of a relatively young age. For this reason, ASA, in conformity with initiatives of academies of the world, is elaborating new strategies to attract and support young researchers in science that will continue to be a priority for ASA in 2012 and in continuity.

From the diagram, we can notice an improvement of the structure in comparison with 2010, age 45-54 is increased from 4 to 5 (with 12, 2 %) and even the age 55-64 from 14 to 18 (with 43, 9), meanwhile it is decreased the number of persons with an age over 65 from 21 to 18 (with 43, 9%).

Regarding to the realization of the economic indices of the ASA, which during 2011, it has been planned 81.5 million lek and has been realized 75.34 million lek, result as followed:




Fig. 3. Realizimi i buxhetit sipas zërave
Realization of the budget according to the data

Shpenzimet e kryera me fondet e buxhetit të planifikuar u realizuan 92 %.

The expenditure made with the funds of the planned budgeted, were realized 92%.




Fig. 4. Realizimi Plan - Fakt / Realization Plan - Fact




Fig. 5. Realizimi i krahasuar i Buxhetit / Compared achievement to the budget.

Nga grafikët e mësipërm vihet re një përmirësim në drejtim të realizimit të treguesve ekonomikë, financiarë e atyre monetarë.

Veprimtarinë e saj, ASHSh e zhvillon përmes seksioneve të saj, përkatësisht Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike dhe atij të Shkencave Natyrore e Teknike.

Për të dy seksionet, në kushtet e ASH-së, është punuar për përcaktimin e kuadrit të përparësive të mbështetjes ekonomike të veprimtarive për kërkim e zhvillim, që ato t'i përgjigjen më së miri zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Objektivi i ASHSh ka konsistuar në vazhdimësi në përmbushjen e prioriteteve shkencore afatshkurtra, afatmesme e perspektive, dhe mobilizimin e shkencëtarëve. Objektivat e ASHSh-së janë në përputhje me Strategjinë për Shkencën, Zhvillimin Teknologjik e Inovacionet në nivel kombëtar.

Financimet e buxhetit janë të drejtuara në mbështetje të veprimtarive të kërkimit në fushat shoqërore e albanologjike janë zhvilluar me përparësi në zgjidhjen e problemeve ekonomike, gjuhësore dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë historike e kulturore, shoqërore, demografike etj.

Me veprimtaritë e saj, Akademia ka synuar realizimin e një qëllimi të rëndësishëm: *kontributin në*

Given the above diagrams, we notice an improvement regarding the achievement of economic, financial and monetary indices.

The ASA develops its activity through its Sections, respectively that of Natural and Technical Sciences and that of Social and Albanological Sciences.

For both Sections, under the new conditions aroused after the renewal of AS, has been worked on defining the framework of priorities to economically support the activities in the research and development field; in order that they respond appropriately to the reliable economic development of the country. The fulfillment of short-term, medium-term, scientific priorities for the future and involvement of scientists in the research activities is a continuous objective of ASA in conformity with the Strategy for Science, Technological Development and Innovations at a national level.

Budget financings are mainly focused on supporting research activities in Social and Albanological field, which have been accomplished having as a priority to solve the economic and the linguistic issues and preservation of values of historical, cultural, social, demographic heritage, etc.

With its activities, it has aimed to accomplish an important objective: *contributing in the creation of a*

formimin e një shoqërie civile cilësore, me mentalitet demokratik e të aftë të përballojë sfidat e integritetit dhe angazhimit të Shqipërisë në familjen e madhe europiane, rritjen e cilësisë së jetës etj.

Po kështu, mbështetje financiare i është dhënë edhe kërkimit në fushat natyrore e teknike, duke zhvilluar me përparësi fushat e teknologjive të informimit e komunikimit, shëndetit publik, pasurive të burimeve natyrore, pyjeve e menaxhimit të tyre, efektshmërisë energjetike, biodiversitetit, mjedisit etj., të lidhura e në përputhje këto me Programet Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZH).

Forcimi i kapaciteteve të ASh-së, e aftë për këshillim të qeverisjes dhe shoqërisë civile vazhdoi të ishte një domosdoshmëri për zhvillimin e vendit, në përputhje edhe me përparësitë e InterPanelit të Akademive të Botës (ALLEA) me arritjen e treguesve të anëtarësimit në Europë, për zhvillimin shkencor (që janë materializuar në kapitullin e 25-të të Pyetësorit të BE-së), realizimi i të cilave edhe në vitin 2011, ka ecur në përputhje me SKZHTI.

Bazuar në fushat përparësore për zhvillimin e vendit, AShSh ka punuar për krijimin e komisioneve të përhershme apo *ad hoc*, duke tërhequr specialistët më të mirë të fushave, për të realizuar studime të rëndësishme të veçantë, kombëtare e më gjerë, të cilat vihen në shërbim të vendimmarrësve. Kësisoj, është vënë në rrugë të mbarë dhe po funksionon Këshilli Ndërkademi i Gjuhës Shqipe, me studiuesit më të mirë të gjuhës dhe i pasuruar me anëtarë të rinj nga akademitë e Shqipërisë dhe Kosovës, Qendra e Studimeve Albanologjike, universitetet, si dhe nga diaspora, për përditësimin e plotësimin me hapa të shpejtë të gjuhës shqipe, të detyrimit madhor të shoqërisë shqiptare brenda vendit e në mbarë botën.

Të tilla komisione do të ngrihen hap pas hapi edhe për fushat të tjera, me synimin që ato të jenë shumëdisiplinore: për fushën e historisë, trashëgimisë kulturore, sociologjisë, ekonomisë, financës, problemeve demografike arsimi, ujit, pyjeve, energjisë, emergjencave civile, bujqësisë dhe ushqimit, biodiversitetit, cilësisë së jetës, mjedisit, etj. Këto komisione do të udhëhiqen nga akademikë të shquar e specialistë të fushave, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre brenda e jashtë vendit.

Përrurimi i ngjarjeve të mëdha dhe i figurave më të shquara të kombit, i vlerësimit edhe i figurave të sotme, të cilat analizohen në hollësi në raport, për secilin nga seksionet, ka qenë një tjetër objektiv, me qëllim kryesor trashëgiminë e vlerave tek gjenerata e re e kërkuesve e tek shoqëria në përgjithësi, duke evidentuar vlera pozitive të shkencës shqiptare në vite, të cilat dhe nuk janë të pakta në historinë e zhvillimit të vendit e më gjerë, në botë.

civil, qualitative society, of democratic mentality, able to face challenges of integration and commitment of Albania in the big European family, increasing also the quality of life, etc.

Financial support has also been given to researches in the field of nature and technical sciences by developing with priority the fields of information and communication technologies, public health, properties of the natural sources, of the forest and their management, energetic efficiency, biodiversity, environment, etc., related to and in line with National Programs for Research and Development (NPRD).

Strengthening of capacities of AS, which are able to counsel the governing and civil society, continued to be a necessity in the development of the country, in conformity with the priorities of Inter-Academies Panel of the world (ALLEA) with the achievements of the indices of the membership in Europe, for the scientific development (materialized in the chapter 25 of the Questionnaire of EU), realization of which even in 2011, has progressed in conformity with the NSDRTI.

Based in priority fields to develop the country, the ASA has worked on establishing permanent or ad-hoc commission, attracting the best specialist of different fields in order to carry out studies of special importance not only at a national level, but even beyond which are also put in the service of decision-makers. Thus, it is in progress and is functioning the Interacademic Council of Albanian Language, with the best researchers of the language and enriched with new members from the Academics of Albania and Kosovo, the Center of Albanological Studies, Universities, even from Diaspora, for the updating and the fulfillment with great steps of the Albanian language, of the major obligation of the Albanian society inside and worldwide.

Such commissions will be established step by step also for multi-disciplinary fields such as: history, cultural heritage, sociology, economy, finances, demographic problems, education, water, forests, energy, civil emergencies, agriculture and food, biodiversity, quality of life, environment, etc. These commissions will be directed by distinguished academics and specialists of the field who develop their activity inside and outside the country.

Promotion of great events and of the most distinguished figures of the nation, evaluation also of today's figures, analyzed in detail in Report, by each of the Sections is another important objective, whose main aim is that the important values be inherited by the new generation of researchers and the society in general, promoting positive values of the Albanian science for years, which are not a few in the history of the development of the country and also worldwide.

Rritja e bashkëpunimit kombëtar e ndërkombëtar, realizimi i marrëveshjeve e protokolleve me institucione kërkimore shkencore e universitare dhe paraqitja e denjë e AShSh-së në takime ndërkombëtare, kanë qenë në fokus të veprimtarisë së saj.

Duhet përmendur këtu edhe një sërë takimesh e kontaktesh me studiues e personalitete të kërkimit shkencor, ku është diskutuar për çështje me interes reciprok dhe janë finalizuar marrëveshje, të cilat trajtohen sipas njësive përkatëse.

Përpyekje të konsiderueshme janë bërë në drejtim të pjesëmarrjes së Akademisë së Shkencave në Programet Kuadër të BE-së apo programe të tjera me karakter kërkimor, ku Akademia në bashkëpunim të ngushtë me AKTI-in, përfaqësohet dhe jep kontribut në nivel ekspertësh në disa nga programet më të rëndësishme (Programet Kuadër) si Transporti dhe Aeronautika, Teknologjitë e Informacionit, Siguria, Bioteknologjia dhe Ushqimi, Shëndeti, Kërkimi dhe Teknologjitë etj.

AShSh ka kontribut në pjesëmarrjen aktive në veprimtarinë e AKTI-t dhe ajo mbulon disa ekspertiza fushash të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim e informacioneve, të cilat bëhen publike nëpërmjet shkrimeve, raporteve, workshop-eve e leksioneve të ndryshme. Nga ana tjetër, jepen mendime në kohë reale edhe për problematika të MASH-it dhe AKTI-it.

Janë realizuar treguesit e buxhetit të vitit 2011 dhe për vitet në vazhdim, projekte për një veprimtari ambicioze kërkimore-shkencore janë parashikuar në projekt-buxhet, sipas një formati të kërkuar së fundmi nga Qeveria. Projekt-buxheti për vitin 2012 është përgatitur nga kryesitë e seksioneve, Njësia e Projekteve, Dega e Financës dhe i gjithë stafi i institucionit në përputhje me të gjitha udhëzimet e Ministrisë së Financave (me ekspertë të buxhetimit), i miratuar në Këshillin Ekzekutiv të AShSh-së. Buxheti i miratuar për AShSh-në për vitin 2012 nuk është i mjaftueshëm për realizimin e të gjitha veprimtarive të parashikuara, sidomos në 100-vjetorin jubilar të Pavarësisë së Shqipërisë dhe 40-vjetorin e themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (për veprimtaritë e botimet në këto jubile).

Nga ana tjetër, Akademia do të marrë të gjitha masat që me fondet që do t'i jepen nga Qeveria, të realizojë përparësitë e saj.

Gjatë vitit 2011, një rëndësi të veçantë patën veprimtaritë që lidheshin me marrëdhëniet e AShSh-së në planin ndërkombëtar. Akademia e Shkencave bashkëpunoi me institucionet homologe e më gjerë, si me Federatën Europiane të Akademive Kombëtare të Shkencave (All European Academies of Sciences - ALLEA), Inter Panelin e Akademive (InterAcademyPanel, a Global Network of Sciences Academies - IAP), Rrjetin e Akademive të Vendeve

The increase of national and international cooperation, the signing of agreements and protocols with scientific research and university institutions and the dignified presentation of the ASA in international meetings, has been in the focus of the activity of the Academy.

We should also mention a series of meetings and contacts with researchers and personalities of scientific research, where it has been discussed on issues of common interest and have been finalized agreements, which will be dealt with later according to the respective units.

Considerable efforts have been made in the aspect of participation of AS in the EU Framework Programs or other programs of research character, where the Academy in close cooperation with ARTI, is represented and contributes at expert level in some of the most important programs (of Programs Framework) such as Transport and Aeronautics, Technologies of Information, Security, Biotechnology and Food, Health, Research and Technologies, etc.

The ASA has contributed by actively participating in the activity of ARTI, which covers several expertise fields of the National Program for Research and Development of the information, which are made public by drafting reports, workshops and various lectures. On the other hand, opinions are given in real time and for the problematic of MES and ARTI.

The indices of budget for 2011 and for the following years have been fulfilled; a budget based on projects for an ambitious research-scientific activity is foreseen in a project-budget, according to a form recently required by the Government. The project-budget of 2012 is prepared by the headships of the Sections, the Unit of Projects, the Department of Finances and all the staff of the institution in conformity with all the directives of the Ministry of Finances (with experts of budget), approved in the Executive Council of ASA. The approving budget for ASA for 2012 is not sufficient for the realization of all the activities previewed, especially in the 100th anniversary of the Independence of Albania and for the 40th anniversary of the foundation of the Academy of Science in Albania (for the activities and the publication in these jubilee).

On the other hand, the Academy shall take all the necessary measures to achieve its priorities by using the fund that shall be granted by the Government.

During 2011, a special importance was given to the activities according to the relations of ASA in an international level. ASA cooperated with homologous institutions and beyond, such as All European Academies of Sciences -(ALLEA), Inter-Academies Panel, a Global Network of Sciences Academies -IAP), the Network of the Third World Academies (TWAS), as well as the scientific organisms CNR-Italy, those of United States, etc.

të Botës së Tretë (TWAS), si dhe organizmat shkencorë CNR-Itali, ato të Kombeve të Bashkuara etj. Do të vazhdojë puna për zbatimin e Marrëveshjes së AShSh-së me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë e të shumë veprimtarive të tjera në rajon, duke patur si objektiv të veçantë bashkëpunimin me jashtë në ndihmë të lidhjeve, njohjes e integritit të Shqipërisë në bashkësinë europiane e forcimit të lidhjeve e saj në botë nëpërmjet rritjes cilësore të bashkëpunimeve në fusha të kërkimit shkencor në shkencat shoqërore e natyrore-teknike.

Akademia e Shkencave do të vazhdojë të ketë objektiv partneritetin në pesë fusha të iniciativës së Programit "ERA" (European Research Area), që konsistojnë në:

(i) bashkëpunimin ndërkombëtar në shkencë dhe teknologji; (ii) intensifikimin e partneritetit në kërkim; (iii) transferimin e teknologjive; (iv) kërkimet në infrastrukturë; (v) zhvillimet më të reja në shkencë etj., për të cilat ajo ka aplikuar me mjaft projekt-propozime.

Gjatë vitit 2012, AShSh ka iniciuar disa lidhje të rëndësishme në nivel botëror dhe europian:

-Akademia e Shkencave, krahas institucioneve prestigjioze ndërkombëtare, përfaqësohet në Këshillin Ndërkombëtar të Shkencës ICSU me qendër në Paris;

- Akademia e Shkencave jep kontribut si anëtare në Komitetin Ekzekutiv të Shoqatës Ndërkombëtare të Oqeanografisë Biologjike;

- Akademia e Shkencave është anëtare e AIESEE-së, dhe kryetare e saj e radhës;

-Akademia e Shkencave është anëtare në UEAA (Union of European Agrarian Academies);

- Akademia e Shkencave realizon një bashkëpunim të gjerë ndërkombëtar me akademitë e shkencave të botës etj.

It shall continue its work on implementing the Agreement with the Academies of Science and Arts in Macedonia and of so many other activities in the region, having as a special objective, the cooperation with foreign institutions to sustain the relations, recognition of the integration of Albania in the European unit and its connections in the world through the qualitative increase of cooperation in fields of the scientific research in social and natural-technical sciences.

ASA will continue to have as an aim to gain the partnership in 5 fields of initiative of the Program "ERA" (European Research Area), which consist in:

(i) international cooperation in science and technology; (ii) intensification of partnership in research; (iii) transfer of technologies; (iv) research in infrastructure; (v) newest developments in science, etc., for which it has applied with so many proposal-projects.

During 2012, ASA initiated several important relations at the world and European level:

-ASA, besides the international prestigious institutions, is represented at the International Council of Science (ICSU) with headquarters in Paris.

-ASA gives its contribution as a member of the Executive Committee of the International Society of Biological Oceanography.

-The ASA is member of AIESEE, and actually heads it;

-The ASA is member of UEAA (Union of European Agrarian Academies);

-The ASA has a wide international cooperation with the Academy of Sciences worldwide.

PJESA E DYTË

Veprimtaritë e seksioneve të AShSh

Akademia e Shkencave e Shqipërisë edhe gjatë vitit 2011 kreu veprimtari të ndryshme të kërkimit e zhvillimit me kontribute të ndryshme në: zhvillimin e vendit në përgjithësi, në drejtim të kërkimit shkencor, arsimimit, të zhvillimit e demokratizimit të shoqërisë, mjedisit, zhvillimeve teknologjike e inovative të biodiversitetit e biologjisë, informacionit, shëndetit e rritjes së kualitetit të jetës, të ekonomisë e biznesit etj., të cilat janë zhvilluar nëpërmjet projekteve, konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare (brenda e jashtë vendit), botimeve, monografive, revistave periodike shkencore, udhëzuesve dhe botimeve të veçanta, botimeve për publikun e gjerë, mësimdhënies në nivelet e ndryshme të arsimit të lartë e të kualifikimit, në takimet publike, nëpërmjet pranisë në median e shkruar e atë televizive, në pjesëmarrjen me ekspertiza e konsulencë, në hartimin e programeve në nivele të ndryshme institucionale, etj.

Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike edhe gjatë vitit 2011 ka vijuar veprimtaritë në tri fushat themelore kërkimore albanologjike.

Kështu, **në albanologji**, këto veprimtari përfshinë tri fusha: të gjuhësisë, të historisë dhe të trashëgimisë së kulturës materiale dhe shpirtërore.

Në kushtet e mundshme për zgjerimin dhe thellimin e kërkimeve, natyrshëm jemi përpara formimit të brezit të ri të kërkuesve në fushat e albanologjisë. Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka në fokusin e saj orientimin e kërkimeve në problematikën shkencore me rëndësi kombëtare, për **ndriçimin e traditave dhe vlerave identitare të kombit në fushë të historisë dhe të kulturës**, vlera që na integrojnë në bashkësinë europiane në mënyrë dinjitoze. E rëndësishme është shtrirja e tre drejtimeve të lartpërmendura të kërkimit shkencor në mbarë hapësirat shqiptare, bashkëpërfshirja potenciale e studiuesve shqiptarë dhe të huaj në trajtimin e problematikave përkatëse:

në fushën e gjuhësisë, në rend të ditës qëndrojnë problemet e gjuhës së njëzuar shqipe për zbatimin e normës dhe përsosjen e standardit;

në fushën e historisë, trajtime të fushave dhe të periudhave ku vërehen shtrembërime ideologjike të së kaluarës, punime me synime përgjithësuëse, hulumtime të arkivave të huaj mbi hapësirat shqiptare në shekuj, ndihmesë kjo në formimin e profesionistëve të rinj;

në fushën e trashëgimisë kulturore, veprimtari për

SECOND PART

The activities of the sections of ASA

The Academy of Sciences of Albania even during 2011 accomplished different activities of the research and development with sensitive contributions in the development of the country in general, in the direction of scientific research; education; development and democratization of society; environment; innovative and technological developments of biodiversity of biology; information, etc.; health and increase of quality of life, economy, and business; which are developed through projects, scientific national and international conferences (inside and outside the country), publications, monographies, periodic scientific journals and manuals and special editions, publications for the whole public, teaching in different levels of high education and qualification, in public meetings through presence in written and media, in the participation in expertise and consultancy, program compilation in different institutional levels, etc.

The section of the Sociable and Albanological Sciences, even during 2011, has preceded its activity in three main Albanological fields of research.

Thus, **in the Albanology field**, it concluded three: 1) of linguistic, 2) history and 3) of the inheritance of the material and spiritual culture.

For the possible conditions for the enlargement and the deepening of researches, we are naturally before the formation of the new generation of the researchers in the fields of Albanology. The Academy of Science of Albania has in its focus, the orientation of researches in the scientific problematic with national importance, **for the illumination of the traditions and the identity values of the nation in the field of history and culture**, values that integrate us in the European community with dignity with our identity as a nation. It is important the expansion of the above-mentioned fields of the scientific research in the whole Albanian territory, thus for the potential co-inclusion of the Albanian researchers and foreigners in the treatment of the relevant problematic:

In the field of linguistics, in the agenda, there remain the problems of the unified Albanian language, for the application of the rules and the perfection of the standard;

In the field of history, treatments of the fields or the periods with ideological deformations of the past, works with general aims, foreign archives investigations over the Albanian spaces in centuries. This helps for the formation of new professionals;

In the field of cultural inheritance, activities for the

identifikimin dhe dokumentimin e trashëgimisë materiale dhe gojore në mbarë trevat shqiptare në shekuj, botime në gjuhën shqipe dhe veçanërisht në gjuhë të huaja, duke rritur bashkëpunimin midis kërkuesve shqiptarë dhe të huaj sipas fushave dhe duke patur parasysh ngjashmëritë dhe dallimet në rajon.

Gjithashtu, në kuadër të festimit të vitit jubilar të 100-vjetorit të Pavarësisë së shtetit shqiptar, si dhe të 40-vjetorit të krijimit të Akademisë së Shkencave, ka qenë synim dhe projektimi i veprimtarive që do të organizohen gjatë vitit 2012. Duke pasur parasysh edhe kontekstin krahasimisht të ri të funksioneve të ASHSh-së dhe bashkëmarrëdhënieve të saj me qendrat e ndryshme kërkimore mbi tematikat shqiptare dhe ato universitare të fushave të ndryshme, është synuar:

- kujdesi për hartimin e monografive dhe botimeve të veprimtarive të ndryshme kërkimore në fushat e albanologjisë me të dhëna të reja, apo këndvështrime në përputhje me kriteret metodike të njohura dhe të bashkëpranuara ndërkombëtarisht;

- dendësimi i përpjekjeve për rritjen profesionale të punonjësve kërkimorë, duke synuar ndarjen e fushave kërkimore sa më të sakta;

- përfshirja e fushave kërkimore albanologjike përherë dhe më shumë në përvetësimin e arritjeve të metodikave të përmirësuara apo tyre të reja, në shërbim të rritjes së efektivitetit të kërkimit shkencor;

- dendësimi i bashkëmarrëdhënieve me ASHAK dhe me akademitë e tjera ballkanike dhe europiane e më gjerë;

- thellimi i bashkëmarrëdhënieve me universitetet shqiptare në përputhje me synimin për lidhjen sa më të ngushtë të kërkimit shkencor me përhapjen e njohurive të arritura tek studentët, të cilët janë dhe masa e studiuesve të ardhshëm, me profesionalizëm përherë e në rritje;

- ndjekja e vijueshme e veprimtarive kërkimore të miratuara, në rrjedhën e tyre kohore, për të garantuar cilësinë dhe përmbushjen e mbarë kërkesave profesionale ndaj tyre.

Si rezultat, gjatë vitit 2011 janë realizuar veprimtari të shumta nëpërmjet projekteve; konferencave kombëtare e ndërkombëtare; seminareve, workshop-eve, botimeve të ndryshme si dhe paraqitjeve në mediat e shkruara dhe televizive në fushën e gjuhës shqipe; të trashëgimisë kulturore e ruajtjes së saj: arkivit të isopolifonisë; të shqipes dhe gjuhëve ballkanike; të medias: gazetarisë europiane, mediave shqipe jashtë territorit të Shqipërisë, medias së shprehjes dhe diversitetit kulturor, komunikimit; studimit të aspekteve të ndryshme ekonomike, etj.

Anëtarët e Seksionit të ShShA kanë realizuar:

- *16 projekte shkencore* (3 kombëtare dhe 13 ndërkombëtare);

identification and documentation of material and verbal inheritance in the whole Albanian territories in centuries, publications in the Albanian language and especially in foreign languages, increasing the collaboration through Albanian and foreign researchers according to the fields, in view of similarities and distinctions in region.

However in the frame of the celebration of the 100th anniversary jubilee of the independence of the Albanian state, as of the celebration of the 40th anniversary of the creation of the Academy of the Sciences, has been even the projection of some activities that will be discussed during 2012. Taking into consideration even the context that in comparison is new in the functions of ASA and its co operations with the different researching centers for the Albanian thematic and those of university of different fields it is aimed to:

- The care are for the compilation of the monographs and the editions of different research activities in the fields of Albanology with new data, or points of view in accordance with the known methodical standards and accepted internationally;

- The density of the efforts for the professional growth of the research employees, aiming the separation of the research fields as correct as possible;

- The inclusion of the research Albanological field, much more in the acquisition of the achievements of improved methods, or those new in service to the growth of the efficiency of the scientific research;

- The density of cooperation with ASAK and with the other Balkan and European Academies and nationwide;

- The deepness of the cooperation with the Albanian universities in accordance with the aim for the close relation of the scientific research with the expansion of the reached knowledge in the students, that are even the mass of the future researchers with professionalism always in increase;

- The consecutive pursuit of the approved research activities, in their time course to guarantee the quality and the fulfillment of all professional requests towards them.

As a result during 2011 have been realized numerous activities through projects; national and international conferences; seminars-workshops; different editions such as the presentations in written and media in the field of the Albanian language; of the cultural inheritance and its conservation: of the isopolyphony; the Albanian and the Balkan languages, the media, European journalism; Albanian media outside the territory of Albania, media of expression and cultural diversity, the communication; the study of different economic aspects, etc.

Members of the Section of ASA have realized:

- *16 scientific projects* (3 national and 13 international);

- 9 konferenca shkencore kombëtare;
- 17 monografi;
- 16 botime në revista shkencore (7 brenda dhe 9 jashtë vendit);
- 33 aktivitete të tjera botuese;
- 70 artikuj popullarizues;
- 44 pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare

- pjesëmarrje në procesin e mësimdhënies e të gjithë Akademikëve dhe Akademikëve të asociuar të Seksionit të ASHSh-së (gjithsej 19) si dhe 4 prej Akademikëve mbi moshën 75 vjeç.

Seksioni i Shkencave Natyrore dhe Teknike në vitin 2011 ka pasur si përparësi veprimtari të orientuara në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacionit, dhe studimeve të orientuara qeveritare në fusha të tilla si: teknologjitë e informimit e komunikimit; shëndetësia dhe shërbimi parësor; rregullimi i regjimit uhor në liqene, lumenj e laguna; shfrytëzimi i energjisë së rinovueshme (gjeotermale, nga biomasa etj.) dhe aplikimeve praktike me projekte pilote, me synim ngritjen e NMV-ve në Shqipëri; përdorimi i metodave bioteknologjike në bujqësi, mjekësi, ushqim e mjedis; vlerësimi, ruajtja dhe rehabilitimi i ekosistemeve natyrore, pyjeve dhe problematikat e menaxhimit të tyre; biodiversiteti dhe cilësia e ushqimit; transferimi dhe zbatimi i teknologjive të reja në fusha të ndryshme e me përparësi si ato të trashëgimisë kulturore; të E-sistemeve e të teknologjive të informacionit; studimet e teknologjive të reja për identifikimin e monitorimin e mjedisit; studimet bujqësore e pastorale, vreshtaria etj.; fusha e emergjencave civile e sigurisë etj.

Këto veprimtari janë zhvilluar në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe të Malit të Zi, Programeve Kombëtare për Kërkim dhe Zhvillim të AKTI-t, ato të Qeverisë, si dhe nëpërmjet punës individuale të akademikëve në sektorët ku punojnë, të cilat janë realizuar nëpërmjet projekteve, konferencave, workshop-eve, konsultave kombëtare e ndërkombëtare. Këto veprimtari jepen hollësisht në rubrikat e mëposhtme.

Anëtarët e Seksionit të ShNT kanë realizuar:

- 34 projekte shkencore, nga të cilat: 6 projekte në kuadër të Programeve Kombëtare për Kërkim e Zhvillim –AKTI; 2 projekte nga Protokollet dypalëshe ndërmjet MASH dhe homologëve të tyre (Slloveni dhe Itali); 2 projekte nga Programi “Cilësi dhe Barazi në Arsim”; 7 projekte nga Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës; 17 projekte në kuadër të programeve të BE-së (FP-7 dhe të organizmave të tjerë ndërkombëtare);

- 9 national scientific conferences;
- 17 monographs;
- 16 editions in scientific journals (7 inside and 9 outside the country);
- 33 other publishing activities;
- 70 popularized articles;
- 44 participations in scientific international conferences

- Participation in the process of teaching of all Academics and the Associated Academics of the Section of ASA (total 19) and also 4 from the Academics over 75 years old.

The Section of Natural and Technical Sciences in 2011 has had as priorities orientated activities in accordance with the National Strategy of Research, Technologies and Innovation, orientated Governmental studies in such fields as: technologies of information and communication; health and primary service; rearrangement of the aquatic regimen in lakes, rivers and lagoons; utilization of renovated (geothermal, from the biomass etc.) and the practical applications with pilot projects with the aim of building the SME in Albania; use of biotechnological methods in agriculture, medicine, food and environment; the valuation, the conservation and the discharge of natural ecosystems; the forests and the problematic of their management; biodiversity and the quality of food; the transfer and the application of new technologies in different fields and with priority, as those of cultural inheritance; the technologies and the E-systems of the information technologies; the studies of new technologies for the identification and monitoring of the environment; pastoral and agricultural studies, the viticulture etc.; in the field of civil emergencies and security etc.

These activities have been developed in the frame of Agreement of Scientific Collaboration with the Academy of Sciences and Arts of Kosovo, and of Montenegro, of the National Programs for Research and Development of ARTI, of Government, and even through individual work of the academics in the sectors where they work. These activities have been realized through projects, conferences, workshops, national and international consultations and are given in detail in the following rubrics.

Members of the Sections of SNT have realized:

- 34 scientific projects, from which: 6 projects in the frame of National Programs for Research and Development-ARTI; 2 projects from the Bilateral Protocols through MES and their counterparts (in Slovenia and Italy); 2 projects from the Program “Quality and Equality in Education”; 7 projects from the Agreement of Collaboration through the Academy of Sciences of Albania and the Academy of Sciences and Arts of Kosovo; 17 projects in frame of the programs of EU (FP-7 and the other international organisms);

- 6 konferenca shkencore (4 ndërkombëtare dhe 2 kombëtare);
- 17 monografi (13 brenda dhe 4 jashtë vendit);
- 84 botime në revista shkencore (29 brenda dhe 55 jashtë vendit);
- 8 aktivitete të tjera botuese;
- 50 artikuj popullarizues;
- 103 pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare shkencore (37 brenda dhe 66 jashtë vendit);
- pjesëmarrje në procesin e mësimdhënies e të gjithë Akademikëve dhe Akademikëve të asociuar të Seksionit të ShNT (gjithsej 22) si dhe 1 prej akademikëve mbi moshën 75 vjeç.

Më poshtë po paraqesim sipas rubrikave të veçanta veprimtaritë kërkimore shkencore dhe botuese të Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike dhe Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike të ASH.

1. PROJEKTE

Me fillimin e veprimtarisë së Agjencisë së Kërkimit, Teknologjive dhe Inovacioneve (AKTI), edhe Akademia e Shkencave nëpërmjet anëtarëve të saj u përfshi institucionalisht apo si bashkautorë në projektet e programeve të ndryshme të PKKZH-së. Nga ana tjetër, akademikët kanë marrë pjesë edhe në projekte në kuadër të Protokolleve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI) duke qenë pjesë aktive e komunitetit shkencor në universitete e në institucione shkencore pranë universiteteve e jashtë tyre.

Në këtë kontekst numri i projekt-propozimeve dhe projekteve të kërkimit në zhvillim ka qenë në parametra më të mirë, në rritje, në krahasim me vitin 2010.

Sipas seksioneve, projektet e zhvilluara gjatë vitit 2011 renditen si më poshtë:

I. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

Veprimtaria e këtij seksioni gjatë vitit 2011, vit pararendës i 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë dhe 40-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, ka ndjekur planet e miratuara nga ASHSh, duke synuar rritjen e shkallës së konsolidimit të skemës së re të veprimtarisë së Akademisë.

Në fushën e gjuhësisë seksioni, gjatë vitit të kaluar, ka pasur veçanërisht në qendër të vëmendje çështjen e shqipes standarde. Duke synuar drejt zgjidhjes së problematikave të kohës për gjuhën shqipe, duke marrë parasysh proceset e zhvillimeve të gjuhës shqipe, po punohet për përmirësimin e rregullave të drejtshkrimit. Bazuar në propozimet e veprimtarive të ndryshme për këtë problem, u ngrit Kryesia e Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe, e përbërë

- 6 scientific conferences (4 international and 2 national);
- 17 monographs (13 inside and 4 outside the country);
- 84 editions in scientific journals (29 inside and 55 outside the country);
- 8 other publishing activities;
- 50 popularized articles;
- 103 participations in scientific international conferences (37 within, 66 outside);
- Participation in the process of teaching of all the Academics and Associated Academics of the SNT Section (22 in total) and also 1 of the Academics over 75.

Below are presented according to the special rubrics, the research-scientific and publishing activities of the Section of the Social and Albanological Sciences and of the Section of Natural and Technical Sciences.

1. PROJECTS

With the initiation of the activity of the Research Agency, Technologies and Innovations (ARTI), and the Academy of Sciences through its members was included institutionally or as co-authors in the projects of different programs of NPRD. On the other side, the academics have participated also in projects in frame of Protocols of Scientific and Technological-Bilateral Cooperation (MES and ARTI) being active part of the scientific community in universities and in scientific institutions close the universities and outside them.

In this context the number of project-proposals and of the research projects in development has been in better parameters, in increase in comparison with 2010.

According the Sections, the developed projects during 2011 are ranked as hereunder follows:

I - SECTION OF SOCIAL AND ALBANOLOGICAL SCIENCES

The activity of this section during 2011, of that precursor of the 100th anniversary of the declaration of the Independence of Albania and 40th anniversary of foundation of the Academy of Sciences of Albania, has followed the approved plans from ASA, aiming the increase of level of consolidation of the new scheme of the activity of the Academy.

In the linguistic language, the section during the last year has had, especially in the center of the attention, the case of the standard Albanian language. Towards the solution of the problematic of time for the Albanian language, taking into consideration the process of the developments of the Albanian language, it is being worked for the improvement of the rules of orthography. Based in the proposals of different activities about this problem, it was held the Presidency of the inter academic Council of

prej akademikësh të fushës, tre prej AShSh-së dhe dy prej AShAK. Kjo kryesi do të nxisë ecurinë e veprimtarisë së këshillit, i cili do të vijojë të jetë organi i vetëm profesional për marrjen e vendimeve eventuale në fushën e shqipes standarde.

Në fushën e botimeve dhe më gjerë, të studimeve të gjuhës shqipe kemi pasur prurje të konsiderueshme, nga të cilat disa janë realizuar të dalin në shtyp nga vetë akademikët dhe më pak nga fondet e buxhetit të Akademisë, çka u bë e pamundur për t'u realizuar për vitin 2011.

Zhvillimin e studimeve historike e ka shënuar përpjekja për t'i çliruar ato nga trajtimet e njëanshme dhe për të forcuar bazën objektive dokumentare të tyre. Për arsye të natyrshme, kjo fushë kërkon brezat e rinj të studiuesve, të cilët krahas kërkimeve sistematike për njohjen sa më të plotë të dokumenteve kryesisht shkrimore, duhet të përvetësojnë metodologjitë bashkëkohore larg kushtëzimeve ideologjike.

Në fushën e trashëgimisë së kulturës materiale dhe asaj jomateriale, kanë qenë në përgjithësi në rritje treguesit e veprimtarive hulumtuese dhe dokumentuese, si dhe përkujdesjet për vlerat tashmë të vëna në mbrojtje. Është bërë i mundur grumbullimi i dukurive etnografike dhe kulturore në përgjithësi, sipas kritereve të njohura, për të mos humbur këto dëshmi historiko-kulturore të pazëvendësueshme.

A. Projekte në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Kërkimor-Shkencor dhe Artistik midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (2010-2011), nënshkruar nga kryetarët e të dy akademive, ku përfshihen projektet e mëposhtme:

1. Projekti ***Mbi veprimtarinë e Këshillit Ndërkademiq për çështje të standardizimit dhe të terminologjisë (2011)***, trajton hapat e marrë për këtë veprimtari me rëndësi kombëtare, të ngritur në vitin 2004 e që për arsye të ndryshme, nuk ka funksionuar normalisht, në një kohë që kërkesa për të trajtuar çështjet e standardit në nivel shkencor është bërë imediate dhe kërkon zgjidhje. Për ta vënë punën mbi baza organizative më të shëndosha dhe për të siguruar një bashkëpunim më efektiv edhe me Qendrën e Studimeve Albanologjike, universitetet e vendit e më gjerë me diasporën, me vendim të kryesive të AShSh dhe AShAK, u krijua Kryesia e Këshillit Ndërkademiq për gjuhën standarde shqipe. Gjatë vitit 2011, u realizua takimi i kryesisë si dhe u lanë detyra për mbledhjen e Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe për vitin 2012.

2. Është përfunduar studimi, ***Harta Arkeologjike e Kosovës vëllimi II (2011)***, si një vepër e përbashkët e të dy akademive shqiptare, drejtuar nga **Akad. Prof. Dr. M. Korkuti**, e cila është propozuar nga autorët të titullohet

the Albanian language composed by Academics of the field, three of ASA and two of ASAK. This presidency will encourage the progress of the activity of the Council, which will continue to be the main professional organ for taking the eventual decisions in the standard Albanian language.

In the field of publications and beyond of the researches of the Albanian language, we have had considerable bearing which are supposed to be showed into the press, from the Academics and a little from the funds of the budget of Academy, which were impossible to be realized for 2011.

The development of the historical studies has been made from the effort to set them free from the unilateral treatments and to force their objective and documentary base. From natural reasons, this field needs that the new generation of researchers, who despite the systematic researchers for knowledge of the whole documents, mainly written ones, must absorb the contemporary methodologies away the ideological conditioning.

In the field of the inheritance of the cultural material and that non-material, indices of the research and documentary activities have been generally in increase, but also the attendance for the values which are already under protection. It is made possible the accumulation of the ethnographic and cultural phenomena in general, according to the known criteria, to not lose these historical-cultural non substituted evidences.

A. Projects in frame of the agreement of the research-scientific and artistic collaboration between the Academy of Sciences of Albania and the Academy of Sciences and Arts of Kosovo (2010-2011), signed from the presidents of the two academics where are included the following projects:

1. The project ***Over the activity of the Inter academic Council for cases of standardization and of terminology (2011)***, treats the undertaken steps for this activity with national importance, held in 2004 that for different reasons, left behind, it has not functioned normally, during a period that the demand to treat the cases of the standard in a scientific level is made immediate and asks for solution. To hold the work over good organized bases and to provide a more effective collaboration even with the Center of the Albanological Studies, the universities of the country and beyond Diaspora, with a decision of the leaders of ASA and ASAK, was created the Presidency of the Inter academic Council for the standard Albanian Language. During 2011, it was realized the meeting of the Presidency and there were also left some duties for the meeting of the Interacademic Council of the Albanian Language for 2012.

2. The study ***"The Archeological Map of Kosovo, volume II" (2011)*** had finally been finished, as a common work for the two Albanian Academies, guided by **Acad. Prof. Dr. M. Korkuti**, which it was proposed by the

Studime arkeologjike në Kosovë. Edhe ky studim synon të njëjtat qëllime profesionale me atë të parashikuar; kështu në thelb nuk kemi të bëjmë me ndryshime në përmbajtjen shkencore të veprës së parashikuar. Vepra tashmë e përfunduar është dorëzuar prej autorëve të AshSh-së në organizmin botues të ASHAK.

3. Në kuadër të projektit: **Ndërmjet tradicionales dhe bashkëkohores. Jeta e përditshme dhe arti popullor në Kosovë (2011)**, me drejtuese Prof. Dr. A. Onuzi nga QSA, është kryer ekspedita etnografike e planifikuar, në krahinën e Zhupës të rrethit Prizren. Nga studimi u identifikuan fakte të rëndësishme që kishin të bënin me përbërjen e popullsisë në këtë krahinë, atë boshnjake, serbe dhe shqiptare, fakte që dëshmojnë qartë, se në kuadër të një konteksti të ri social dhe politik, popullsia atje është në gjendje të negociojë në lidhje me identitetet kolektive (etnike, religjioze etj.). Qëllimi kryesor i kësaj ekspedite hulumtuese qe vëzhgimi i ndryshimeve në fushën e kulturës materiale. Dy aspekte kanë qenë objekt konkret: veshjet, përfshirë dhe artin popullor dhe banesa, e cila përfaqëson rastin më kompleks të shndërrimeve kulturore.

4. Në kuadër të projektit **Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit**, të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në nëntor 2011 në Prishtinë u zhvillua Sesioni Shkencor Ndërkombëtar, ku kontribuan me pjesëmarrjen e tyre edhe **Akad. K. Topalli, Akad. Prof. Dr. Bahri Beci**, Prof. S. Mansaku, A. Omari, R. Përnaska etj. Në këtë sesion shkencor u trajtuan çështje të historisë, të ndikimeve dhe marrëdhënieve të shqipes me gjuhët e tjera ballkanike, roli i këtyre marrëdhënieve në rrjedhë të kohës. Kjo veprimtari shkencore ndërkombëtare solli prurje interesante në lidhje me problematikën e trajtuar.

B. Projekte të mbështetura nga akademitë e shkencave dhe organizma europianë apo ndërkombëtarë

1. Projekti **Për dialog ndërkulturor mes Italisë dhe Ballkanit** (APQ Ballkan, Linja 2,4 Dialog dhe Kulturë) VATRA, për shkëmbimet e materialeve me vlerë për albanologjinë dhe kulturën e vendeve pjesëmarrëse në projekt, në rrjetet bibliotekare përkatëse, i filluar më 2010, u realizua dhe dha frytet më 2011: realizimi i një sistemi të integruar katalogimi dhe shfrytëzimi i fondeve, që u përkasin strukturave bibliotekare të zonës italiane dhe asaj juglindore të Ballkanit, të përfshira në projektin *Biblioteka elektronike e siteve arbëreshe - BESA 2*.

Në vitin 2011 u bë i mundur shfrytëzimi, përmes internetit, i katalogëve të veçantë me interes **albanologjik e ballkanologjik** i disa bibliotekave të specializuara të rajoneve të Siçilisë, Pulias, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Në krijimin e një katalogu elektronik të përbashkët me rreth 35 000 rekorde,

authors to be titled **Archeological Studies in Kosovo**. Also this study tends to realize the same professional objectives as the one predicted; thus basically, we do not have to do with changes in the scientific content of the predicted work. The work already finished has been handled by the authors of ASA in the editing organization of ASAK.

3. In frame of the project "**Between the traditional and the modern**" -*The daily life and the folk art in Kosovo (2011)*, with the leader Prof. Dr. A. Onuzi by QSA, it is accomplished the planned ethnographic expedition, in the region of Zhupa of the district Prizren. From the study, there have been identified important facts that had to do with the composition of the population in this region, the Bosnian, the Serbian and the Albanian one, facts that testify clearly that in frame of a new social and political context, their population is in condition to negotiate in relation to the collective identities (ethnic, religious, etc.). The main purpose of this investigative expedition was the observations of the changes in the field of the material culture. Two aspects have been concrete objects of this observation: clothing, including folk art and residences, which represents the most complex case of the cultural transformations.

4. In the frame of the project "**Albanian language and those of Balkans**", organized by the Academy of Science and of Arts of Kosovo, was developed the International Scientific Section (November, 2011), in Prishtina, where **Acad. Prof. Dr. K. Topalli, Acad. Prof. Dr. Bari Beci**, Prof. S. Mansaku, A. Omari, R. Përnaska, etc. contributed with their participation there. In this scientific section there were treated cases of history, of the effects and the relations of the Albanian language with other Balkan languages, the role of their relation during the period. This international scientific activity brought some interesting bearing in relation to the problems of the Balkan languages.

B. Projects supported by the Academy of Science and european or international organisms

1. **Project for an intercultural dialogue between Italy and Balkans** (APQ Balkans Line 2,4 Dialogue and Culture) VATRA, for the exchanges of the materials, valuable for the albanology and the culture of the participant countries in the project, in the relevant librarian circuits, started in 2010, was realized and gave the main products in 2011: the realization of an integrated system of scheduling and the exploitation of the funds which belong to the librarian structures of the italian and the southeastern zone of Balkans, included in the project *Electronic Library of the Arbëresh Sites -BESA 2*.

During 2011 became possible the exploitation, through Internet, of the special catalogues with **Albanological and Balkans** interest of some specialized libraries of the Regions of Sicily, Pulia, Albania, Montenegro and Macedonia. In the creation of a common electronic catalogue with about 35 000

Biblioteka Shkencore mori pjesë duke përzgjedhur dhe nxjerrë rreth 3 000 rekorde të pranishme në BSh, përgjithësisht botime të Akademisë, të cilat u regjistruan në këtë katalog kolektiv me qëllimin për të vlerësuar trashëgimitë librare dhe arkivistike me interes albanologjik. Më 4 maj 2011 në Bibliotekën Qendrore të Palermos në Itali, u zhvillua dhe Kuvendi përfundimtar i projektit VATRA, i cili ndër të tjera, solli sugjerime në lidhje me një fazë të mëtejshme të projektit, për digjitalizimin e disa librave të rrallë dhe disa dokumenteve të rëndësishme, aktualisht në pronësi të disa strukturave pjesëmarrëse në projekt. Ky shfrytëzim i informacionit shkencor dhe kulturor që sot është i përjashtuar nga konsultimi direkt i lexuesve dhe i studiuesve (katalogët e përbashkët sjellin vetëm të dhënat bibliografike dhe vendin ku gjendet vepra), do të ofrojë, përmes një baze të dhënash të përbashkëta, akses të menjëhershëm të burimeve të digjitalizuara.

2. Projekti **Mediat mbarëshqiptare jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë**, organizuar nga Departamenti i Gazetarisë i Universitetit të Strasburgut (shpallur “Katedër e UNESCO-s, Francë”) me drejtues shkencor **Akad. Artan Fuga**. Objekt i kërkimit shkencor i këtij projekti ishte dhënia e një tabloje mbi arritjet dhe problematikat e mediave shqiptare në Ballkan.

3. **Mediat e shprehjes të diversitetit kulturor**, projekt i drejtuar nga Departamenti i Gazetarisë i Universitetit të Strasburgut, Francë, me anëtar të Komitetit Drejtues të Projektit kërkimor shkencor **Akad. Prof. Dr. Artan Fuga**. Objektivi i këtij projekti ishte të evidentonte se në çfarë mënyre dhe prirjesh shfaqet komunikimi ndërkulturor i mediave në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore.

4. Projekti **Studime mbi gazetarinë evropiane**, i organizuar nga Departamenti i Gazetarisë së Universitetit Italian të Luganos (Zvicër) me drejtues të grupit kërkimor shkencor të këtij projekti ndërkombëtar **Akad. Prof. Dr. Artan Fuga**. Financimi i projektit u bë nga Agjencia e Kërkimit Shkencor të Zvicrës dhe qëllimi kryesor i tij ishte përpunimi i studimeve mbi gjendjen e gazetarisë shqiptare dhe shkëmbimi i informacioneve me qendrat e tjera shkencore mbi gazetarinë evropiane.

5. Gjatë vitit 2011, me mbështetjen e Fondacionit Soros “Shoqëria e Hapur”, u realizua projekti **Komunikimi në institucionet e mbyllura**, me drejtues shkencor **Akad. Prof. Dr. Artan Fuga**. Në këtë projekt, qëllimi i kërkimit shkencor ishte studimi i prirjeve të komunikimit masiv dhe individual në institucionet e mbyllura në Shqipëri.

6. Në kuadër të monitorimit të legjislacionit nga pikëpamja e barazisë gjinore, mbështetur nga UNDP, UN Women, u zhvillua projekti **Local Legal Expert to Review Albanian Legislation from Gender Equality Perspective**, ku **Akad. Assoc. Prof. Dr. Aurela Anastasi**

records, the Scientific Library participated in choosing and showing about 3000 records present in the SL, generally editions of the Academy, which were registered in this collective catalogue with the purpose to evaluate the archivist and librarian inheritances with Albanological interest. On 4 May 2011 in Palermo of Italy, in the Center Library of the Province of Sicily, was also held the final Assembly of the project VATRA, which brought some suggestions in relation to a following phase of the project, for the digitalization of some rare books and some important documents that actually are the property of some participative structures in project. This exploitation of the scientific cultural information that today is excluded from the direct consultation of the readers and researchers (the common catalogues bring only the biblical data and the place where the work is found), will offer, through a base of common data, an immediate access of digitalized sources.

2. The project **Albanian Media outside the territory of the Republic of Albania**, organized from the Department of Journalism of the University of Strasbourg (declared “Chair of UNESCO, France”) with scientific leader **Acad. Prof. Dr. Artan Fuga**. An object of the scientific research of this project was the presentation of a tableau of achievements and problematic of Albanian Media in Balkans.

3. **The Media of the expression of the cultural diversity**, project directed by the Department of Journalism of the University of Strasbourg, France, with members of the Leading Community of the research scientific Project **Akad. Prof. Dr. Artan Fuga**. The objective of this project was to make obvious the ways and the inclination that the intercultural communication of Media is presented in the countries of the Central and Eastern Europe.

4. The project **Studies over the European journalism**, organized from the Department of Journalism of the Italian University of Lugano (Sweden) with a leader of the research scientific group of this international project **Acad. Prof. Dr. Artan Fuga**. The financing of the project was done by the Research Scientific Agency of Sweden and its main objective was the elaboration of the studies over the situation of the Albanian journalism and the exchange of the information with the other scientific centers over the European journalism.

5. During 2011, with the support of the Foundation Soros “The Open Society”, it was realized the project **Communication in the closed institutions**, with scientific Leader **Acad. Prof. Dr. Artan Fuga**. In this project, the research and scientific objective was the study of the inclinations of the massive and individual communication in the closed institutions of Albania.

6. In the frame of monitoring the legislation by the point of view of the gender equality, supported by UNDP, UN Women, it was developed the project **Local Legal Expert to Review Albanian Legislation from Gender Equality Perspective**, where **Acad. Assoc.**

dha kontributin e saj duke sjellë realitetin shqiptar mbi gjendjen ekzistuese të problematikës së legjislacionit për barazinë gjinore.

7. Projekti **Arkivi i isopolifonisë popullore shqiptare**, zhvilluar me mbështetjen e UNESCO-s, u drejtua nga **Akad. Prof. Dr. Vasil Tole**. Në kuadër të këtij projekti po punohet për krijimin e një Arkivi kombëtar të isopolifonisë popullore shqiptare (mars 2011- mars 2012).

8. Në kuadër të projektit **Furnizimi me ujë të pijshëm i Shqipërisë**, të financuar nga KfW Bankengruppe, **Akad. Asoc. Prof. Dr. Kosta Barjaba**, mori pjesë në hartimin e master-planit. Elemente parësore qenë: vlerësimi ekonomik dhe social, ndërmarrjet ekonomike, institucionet, turizmi dhe popullsia, si faktorë përcaktues të kërkesës për ujë të pijshëm.

9. Projekti **Përdorimi i literaturës shkencore on-line, ERA 2011, u bë i mundur në sajë të financimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Sllovenisë**, zbatuar midis Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë dhe Qendrës Rajonale për Sistemet e Informacionit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor, Maribor, Slloveni, nëpërmjet të cilit është bërë e mundur që të përfitohet aksesimi në një nga bazat më me peshë në literaturën on-line të fushave të ndryshme shkencore, në bazën e të dhënave, ProQuest.

Marrëveshja u nënshkrua më 29 prill 2011 dhe baza është e përdorshme për një periudhë 6-mujore. Nga kjo marrëveshje përfitojnë të gjitha bibliotekat publike në Shqipëri. Baza ProQuest është prezantuar me mjete informative (poster, informacione të shkruara, referenca, etj.), që bëjnë të qartë përmbajtjen e kësaj baze në përgjithësi, të qendrës ProQuest për komunitetin akademik shqiptar, të fushave të shkencës së bazës ProQuest dhe të bibliotekave që përfitojnë nga ky shërbim.

Panorama e projekteve për këtë seksion paraqitet si më poshtë:

Prof. Dr. Aurela Anastasi gave her contribution giving the Albanian reality over the present situation from the problematic of the legislation over the gender equality.

7. The project **Archive of Albanian folk isopolyphony**, created from the support of UNESCO, was directed by **Acad. Prof. Dr. Vasil Tole**. In the frame of this project it is being worked for the creation of a National Archive of the Albanian folk isopolyphony (March 2011- March 2012).

8. In the frame of the project **Supply with potable water of Albania**, financed by KfW Bankengruppe, **Acad. Assoc. Prof. Dr. Kosta Barjaba**, participated in the compilation of the mater-plan. The first priority has been: the economic and the social valuation, the economic enterprises, institutions, tourism and population, as defining factors of the demand for potable water.

9. The project **"The use of the scientific use on-line"-Era-2011**, became possible by the financing of the Ministry of Foreign Affairs of Slovenia, applied between the Academy of Sciences in Albania, Tirana and the regional Center for the Systems of the Librarian Information and the Systems of the Research Information, Maribor, Slovenia, through which it is made possible to profit the access in one of the most important bases in the literature on-line of different scientific fields, in the Base of data, ProQuest.

The Agreement was signed on 29 April, 2011 and the base is useful for a period of 6 months. From this agreements, there can profit all the public Libraries in Albania. The ProQuest Base is presented with informative means (poster, written information, references, etc.) which make clear the content of this base in general, of the ProQuest Center for the Albanian Academic Community, of the fields of Science of the ProQuest Base and of the Libraries which profit from this service.

The panorama of the projects for this section is presented as follows:




Fig. 6. Projektet e seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike
Projects of the Section of the Social and Albanological Sciences.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

A. Projekte të mbështetura nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim (PKKZH–AKTI), Protokolle të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Dypalësh (MASH dhe AKTI) dhe programe të tjera (Cilësi dhe Barazi në Arsim, BB dhe MASH).

Akademia e Shkencave nëpërmjet anëtarëve të saj u përfshi institucionalisht apo me bashkautorë në projekte e programe të ndryshme të PKKZH-së.

Në këtë kontekst numri i projekt-propozimeve dhe projekteve të kërkimit në zhvillim ka qenë në parametra më të mirë, në rritje në krahasim me vitin 2010. Gjithashtu, akademikët kanë patur kontribut edhe gjatë 2011 me pjesëmarrjen aktive në grupet e ekspertizave për përzgjedhjen e projekt-propozimeve, vlerësimin afatmesëm të ecurisë së projekteve të PKKZH-së si dhe në forume të ndryshme, promovime të programeve europiane etj.

Projektet e zhvilluara gjatë vitit 2011 në fushat e shkencave natyrore-teknike renditen si më poshtë:

PROGRAME KOMBËTARE PËR KËRKIM DHE ZHVILLIM (PKKZH - AKTI)

1. “Aplikimi i Teknologjisë së Imazheve Radar (PSI SAR) në vlerësimin dhe parashikim e integruar të fenomeneve gjeodinamike (rëshqitje dhe mbihedhjet), me qëllim zbutjen e pasojave në zonat urbane dhe turistike të rajonit Durrës-Kavajë”, Projekt i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (ShGjSh) dhe Akademisë së Shkencave me drejtues shkencor Dr. M. Lamaj, A. Avxhiu, L. Moisiu (ShGjSh) dhe bashkëpunëtorë **Akad. S. Bushati** dhe **Akad. Prof. Dr. N. Frashëri**. Projekti financohet nga Programi Kombëtar për Kërkim dhe Zhvillim “Biodiversiteti dhe Mjedisi” 2010-2012. Ai synon eksperimentimin e përdorimit të imazheve satelitore, në veçanti të tipit radar (SAR ~ Synthetic Aperture Radar), për studimin e rëshqitjeve të tokës në zonën Durrës-Kavajë dhe të dinamikës të vijës bregdetare në zonën e Semanit dhe Patokut. Grupi i Akademisë së Shkencave ka për objektiv studimin e dinamikës të vijës bregdetare. Në vazhdim të studimeve të kryera në vitin 2010, edhe në vitin 2011 janë marrë rezultate të shumta në drejtim të kësaj teknologjie të re.

Grupi i Akademisë së Shkencave në realizimin e objektivave të studimit të dinamikës të vijës bregdetare, ka zgjidhur problemet teorike-metodike, por realizimi i projektit në përgjithësi është penguar nga mosdhënia e fondeve për vitin 2011, sipas parashikimeve të aprovuara për zhvillimin e tij.

2. “Studim emergjent arkeologjik i kalasë së Tiranës

II- SECTION OF THE NATURAL AND TECHNICAL SCIENCES

A. Projects supported by the National Program for Research and Development (NPRD-ARTI), Protocols of the Scientific, Technical and Bilateral Collaboration (MES and ARTI) and other programs (Quality and Equality in Education, BB and MES).

The members of the Academy have taken part even in projects in frame of the Protocols of the Scientific and Bilateral Technical Collaboration (MES and ARTI).

In this context, the number of the project-proposals and of the projects of research in development has been in better perimeters, in comparison to 2010. The Academics has also had a contribution during 2011, in the active participation in the groups of expertise for the selection of the project-proposals, the middle term valuation of the preceding of the projects of NPRD, as well as in different forums, promotions of different European programs, etc.

The developed projects during 2011 in the fields of the natural-technical sciences are classified as it follows:

NATIONAL PROGRAMS FOR RESEARCH AND DEVELOPMENT (NPRD OF ARTI)

1. “The Application of Technology of the Radar Images (PSI SAR) in the valuation and the integrated prediction for the geodynamic phenomena (slides and overthrowing), with the aim to soften the consequences in the urban and touristic zones of the region Durrës-Kavajë”, Project of the Albanian Geologic Service (AGS) and of the Academy of Sciences with scientific leader Dr. M. Lamaj, A. Avxhiu, L. Moisiu (AGS) and collaborators such as **Acad. Prof. Dr. S. Bushati** and **Acad. Prof. Dr. N. Frashëri**. The project is financed by the National Program for Research and Developments “Biodiversity and Environment” 2010-2012. It aims the experimentation of the use of the satellite images, especially of the radar type (SAR ~ Synthetic Aperture Radar), for the study of the slides of the land in the zone Durrës-Kavajë and of the dynamics of the coastline in the zone of Seman and Patok. The group of Academy of Sciences has an objective for the study of dynamics of the coastline. In the preceding of the studies realized in 2010, even in 2011, there were taken several results in direction to this new technology.

The group of the Academy of Science in the realization of the objectives of the study of dynamics of the coastline has solved the theoretical-methodical problems, but the realization of the Project in general was prohibited by the funds which were not taken in 2011, according to the approved predictions for its development.

2. “An archaeological urgent study of Tirana castle

nëpërmjet teknologjive të reja gjeofizike të ERT dhe gjeoradarit, Projekt i Institutit të Gjeoshkencave, të Universitetit Politeknik të Tiranës, me drejtues Dr. H. Recin dhe bashkëpunëtorë Akademinë e Shkencave me përfaqësues **Akad. S. Bushati dhe Akad. M. Prof. Dr. Korkuti** dhe Geo & Co, S. Allkja, Programi Kombëtar për Kërkim e Zhvillim "Biodiversiteti dhe Mjedisi" (PKKZH), 2010-2012, i iniciuar nga Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Objektivat e projektit ishin futja në përdorim e teknologjive të reja gjeofizike me metoda tomografike me teknika instrumentale të ditëve të sotme. Testimet u bënë edhe me një metodë gjeofizike të avancuar, me gjeoradar. Gjithashtu, në këtë kuadër u punua për optimizimin e metodikave të matjeve, përpunimit e interpretimit, bazuar në investigime edhe në site të tjera arkeologjike, si në Apolloni e në Bylis, ku me përkrahjen edhe të specialistëve (respektivisht M. Haxhimihali dhe Prof. Asoc. Dr. A. Vreka), u krye një vëllim i konsiderueshëm punimesh gjeofizike.

Prof. Dr. S. Bushati, the Acad. Assoc. Prof. Dr. E. Kongjika, MSc. B. Shkreta, (Academy of Sciences) A. Paparisto (UT), Assoc. Prof. Dr. E. Gjermeni (Member of Parliament of Albania) and Prof. Dr. Z. Çavo (Marin Barleti University), in cooperation with the Academy of Sciences and Arts of Kosovo, Academy of Sciences and Arts of Montenegro and the Academy of Sciences and Arts of Macedonia.

6. The project **“Safeguard, Battlefield and valorization of genetic resources in South East Europe area” (GERMO)**, was prepared in the framework of the Program of South-eastern Europe (*Transnational Cooperation Programme: European Territorial Cooperation, 2007-2013*), with the leader Prof. Dr. Luigi Ricciardi, University of Bari, Italy, in collaboration with Prof. Dr. L. Dinga (Botanical Garden, FNS, TU) and the Acad. Assoc. Prof. Dr. E. Kongjika (Academy of Sciences of Albania).

The implementation of the project-proposal GERMO is based on the improvement of the cooperation between the countries (Italy, Serbia, Bosnia & Herzegovina, Albania, Montenegro, Croatia, Hungary and Slovenia) for the management of genetic resources. The idea of the project will be the preservation and collection of genetic resources of various species of international interest (e.g., in the horticulture sector and aromatic species) and the evaluation and use of local germplasm, appropriate to give the typical products that have economic values for small and medium enterprises. Another important would be the breeding, the characterization and the preservation of germplasm collected in all countries, and in Bari (Bari University and Institute IGV). Such duplicate collections shall be recorded by international descriptors and shall be available for public and private institutions, enterprise of seeds, etc.

The project proposal is important, because it demonstrates the high efficiency and capacity of partners in collecting and conservation of germplasm to reduce genetic erosion and to improve the prevention of environmental risks (the genetic resources, thanks to high adaptability to the environment, can be considered useful to avoid drought, high temperatures, factors of desertification etc.).

7. The Acad. Prof. Dr. N. Frashëri has prepared the project proposal **“The Glider and naval Platform for air quality in the Adriatic coast and nearby mountains.”** GAPAQUA, within the IPA. The project aims at monitoring the impact of the release of gases from ships in the Adriatic Sea in the reduction of air quality on the Adriatic coast and coastal areas. There will be combined the land and sea observations to specify the advance of pollutants focusing on their impact on the mountains opposite the Adriatic. Surveys will be accompanied by

modelime të atmosferës për të arritur në një studim global të formimit, zhvillimit dhe shkatërrimit të ozonit dhe aerosoleve në rajonin e Adriatikut.

8. **Akad. Prof. Dr. N. Frashëri** ka përgatitur projekt-propozimin **“Projektimi dhe zhvillimi i rrjetave të komunikacionit dhe shkëmbimit të njohurive mbi projektet inovative të përdorimit të TIK, IDAASI”**. Projekti synon në zhvillimin e rrjetave të brendshme të universiteteve në mënyrë të pajtueshme, zhvillimin e një sistemi menaxhimi shumë-nivelesh për të përballuar ndërveprimet e brendshme si dhe midis universiteteve për bashkëpunimin në fushat e didaktikës, administrimit dhe kërkimit. Do të realizohet një strukturë bashkëpunimi e aftë të përballojë kërkesat e universiteteve dhe ndryshimet e tyre.

9. **Akad. Prof. Dr. N. Frashëri** ka përgatitur projekt-propozimin **“Zhvillimi i njohurive për organizimin e qëndrueshëm të transportit KHE-STO”**. Objektivi është përmirësimi i kompetencave dhe njohurive për politikëbërësit dhe në nivel lokal për përmirësimin e kapjes të zonave marginale në shërbim të strategjisë së Gotenburg/Lisbonë. Synohet në krijimin e sistemeve inovative për forcimin dhe integrimin e rrjetave aktuale të infrastrukturës për zhvillimin e transportit dhe shërbimeve të komunikacionit, për një lëvizshmëri të qëndrueshme në sistemin aktual të transportit dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, eficient, të sigurtë dhe të integruar në rajonin e Adriatikut nëpërmjet bashkëveprimit në zonat kufitare.

10. **Akad. Prof. Dr. N. Frashëri** ka përgatitur projekt-propozimin **“Edukimi në Informatikë” Programi ERASMUS LLP: ETN COMPETE**. Projekti synon rritjen e kompetencës në edukimin në informatikë: së pari, zhvillimin e një kuadri evropian për edukimin në informatikë në të tre nivelet universitare dhe pasuniversitare; dhe përmirësimin e programeve për këto nivele në bazë të këtij kuadri. Kuadri do të zhvillohet në bazë të përvojës kolektive dhe rezultatet e tri rrjetave të mëparshme për “edukimin dhe trajnimin evropian në informatikë”, “edukimin doktorale në informatikë” dhe “mësimi, kërkimi dhe inovacioni në edukimin informatik”.

11. **Akad. Asoc. Prof. Dr. N. Gruda** ka kryer detyrën e ekspertit (në emër të Zyrës Federale të Bujqësisë dhe Ushqimit të Gjermanisë), në vlerësimin, miratimin dhe shoqërimin e projekteve kërkimore shkencore (rreth 50 “collaborative projects” me mesatarisht 4,4 “sub-projects” për secilën prej tyre nga aplikimet e realizuara nga universitete dhe shkolla të larta, institucione kërkimore shkencore, organizata shtetërore e NGO-s, si dhe ndërrmarje të prodhimit e shërbimit në fushën e tij të ekspertizës), si edhe raportimin e risive në fushën e kërkimit shkencor dhe zhvillimit eksperimental në Ministrinë Federale të Ushqimit, Bujqësisë dhe

modeling of the atmosphere to reach a global study of the formation, development and destruction of ozone and aerosols in the Adriatic region.

8. The **Acad. Prof. Dr. N. Frashëri** has prepared the project proposal **“Design and development of networks of communication and exchange of knowledge on innovative projects of the use of ICT, IDAASI”**. The project aims at developing internal networks of universities in a consistent manner, the development of a multi-level management system to cope with internal interactions and cooperation between universities in the fields of didactics, administration and research. It will be realized a structure capable to sustain the requirements of universities and their changes.

9. **Acad. Prof. Dr. N. Frashëri** has prepared a project proposal **“Development of knowledge for the sustainable organization of transport KHE-STO.”** The objective is to improve the competencies and knowledge for policy makers and in a local level to improve the capture of marginal areas in the service of Gothenburg Strategy / Lisbon. It is aimed at creating of the innovative systems for strengthening and integration of current networks of infrastructure for the development of transport and communication services, for a sustainable mobility in the current transportation system and the achievement of a sustainable, efficient, safe and integrated development in the Adriatic region through cooperation in border areas.

10. **Acad. Prof. Dr. N. Frashëri** has prepared the project proposal **“Education in Informatics” LLP ERASMUS Program: ETN COMPETE**. The project aims to increase competence in computing education: first, developing a European framework for education in computing in the three undergraduate and graduate levels, and to improve programs for these levels on the basis of this framework. The framework will be developed on the basis of the collective experience and the results of three previous networks “European education and training in computing”, “Doctoral education in computing” and “Teaching, research and innovation in computing education.”

11. **Acad. Assoc. Prof. Dr. N. Gruda** has fulfilled the task of the expert (on behalf of the Federal Office of Agriculture and Food, Germany), in the evaluation, approval and guidance of scientific research projects (about 50 “Collaborative projects” with an average 4.4 “sub-projects” for each of them derived from applications realized from universities and colleges, research and scientific institutions, governmental organizations and NGO, also undertaking of the production and service in its field of expertise), as well as the report on innovations in the field of scientific research and experimental development in the Federal

Mbrojtjes së Konsumatorit, si edhe në entet e tjera përkatëse.

Harta e projekteve për Seksionin e Shkencave Natyrore Teknike paraqitet si më poshtë:

Ministry of Food, Agriculture and Consumer Protection, as well as other relevant bodies.

Indicators of the projects for the Section of Natural Sciences is presented as follows:




Fig. 7. Harta e shpërndarjes së projekteve të SShNT (Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike)
/ Distribution of projects of SNTS

Siç shihet nga grafiku në aktivitetin kërkimor të ASHA dominojnë projektet ndërkombëtare, fryt i përpjekjes së akademikëve dhe i nivelit të tyre të performancës.

Numri i aplikimeve ka qenë edhe më i madh po të kemi parasysh vitin 2010.

As seen from the graph in research activity of ASH dominate international projects, product of the effort of academics and their level of performance.

The number of applications has been even greater if we consider the year 2010.

II. KONFERENCA SHKENCORE

A. Konferenca shkencore ndërkombëtare

Viti 2011 për ASHSh-në ka qenë vit i rëndësishëm për zhvillimin e konferencave dhe simpoziumeve ndërkombëtare për problematikat kryesore që shqetësojnë shoqërinë dhe ekonominë shqiptare. Në bashkëpunim me institucione të tjera dhe në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet akademive, janë paraqitur rekomandime me vlerë për zgjidhjen e këtyre problemeve si për pyjet, për përdorimin e metodave bioteknologjike në mjekësi, bujqësi, mjedis, sigurinë ushqimore etj., për ruajtjen e biodiversitetit natyror dhe bujqësor, në industrinë e përpunimit të perimeve dhe në fushën e industrisë kimike, të prodhimit ushqimor, të vlerësimit të ruajtjes së mjedisit, për trashëgiminë kulturore etj.

Në kuadër të bashkëpunimeve me institucione të tjera, në zbatim të marrëveshjeve të bashkëpunimit ndërmjet akademive apo të paraqitjes së rezultateve të përfundimit të projekteve, ASHSh ka zhvilluar aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare. Gjithashtu, bazuar në të dhënat e dërguara nga Anëtarët e Rregullt dhe ata të Asociuar të ASHSh, të cilat nuk janë të plota, rezulton se ka pasur një pjesëmarrje të gjerë në veprimtari

II. SCIENTIFIC CONFERENCES

A. International Scientific Conference

The year of 2011 for ASA has been an important year for the development of International Conferences and Symposiums on key issues that concern the Albanian society and economy. In collaboration with other institutions and in the implementation of the cooperation agreements between academies, there are presented valuable recommendations to solve these problems as for the forests, use of biotechnological methods in medicine, agriculture, environment, food safety etc., for the conservation of natural and agricultural biodiversity, for the vegetable processing industry and in the field of chemical industry, food production, evaluation of environmental conservation, for cultural heritage etc.

In the context of collaborations with other institutions, in the implementation of cooperation agreements between the academies or the presentation of the results of project completion, ASA has developed significant international activities. Also, based on data submitted by the Regular Members and those Associated in ASA, that are incomplete, it results that there has been a broad participation in international

shkencore ndërkombëtare, të cilat po i citojmë përmbledhtazi sipas seksioneve.

I. SEKSIONI I SHKENCAVE SHOQËRORE DHE ALBANOLOGJIKE

1. Në kuadër të veprimtarive shkencore të Shoqatës Ndërkombëtare të Studimeve të Europës Juglindore (AIESEE), të cilën aktualisht e kryeson Shqipëria me **Akad. Prof. Dr. L. Omari**, u mbajt në Varshavë Konferenca ndërkombëtare **“Imazhi i Rusisë në Ballkan”**, të cilën e hapi **Akad. Prof. Dr. L. Omari**. Në këtë konferencë, Prof. Dr. P. Xhufi mbajti referatin **“Nga Pjetri i Madh te Lenini: përthyerje të faktorit rus në mendimin politik shqiptar”**, i cili u mirëprit për hulumtimin e gjetjeve historike dhe cilësinë e interpretimit të tyre.

2. **“Education in “turbulent times” - the Albania case in European and global context”**, konferencë e përbashkët e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë me Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, AIS dhe Albanian University (21-22 nëntor 2011) me drejtues **Akad. Asoc. Prof. Dr. A. Angjeli**. Në të u diskutuan probleme me rëndësi për gjendjen e arsimit të lartë në Shqipëri.

3. Konferenca shkencore **“75-vjetori i lindjes së shkrimtarit të shquar Ismail Kadare”**, pati në qendër të tematikës së saj shkrimtarin e madh Akad. Ismail Kadare, personalitet i shquar dhe protagonist i zhvillimeve letrare e kulturore në Shqipëri dhe jashtë saj, gjatë një harku kohor mëse gjysmëshekullor. Krahas fjalës së hapjes nga **Akad. Prof. Dr. G. Beqiraj**, kryetar i ASHSh-së dhe Dr. A. Bumçi, ministër i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, u mbajtën edhe tre referate: **“Rruga krijuese e Ismail Kadaresë”** nga Prof. Dr. Sh. Sinani, **“Gjuha Alegorike e Kadaresë si antimodel i gjuhës propagandistike të regjimit”** nga Prof. Dr. M. Marku dhe **“Disidenca estetike e Kadaresë”**, e mbajtur nga A. Tufa.

II. SEKSIONI I SHKENCAVE NATYRORE DHE TEKNIKE

1. Konferenca ndërkombëtare **“Forest Policy and Reforms in Albania towards EU Standards”**, **Forumi i parë Shqiptar për Pyjet**, e organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia Mbretërore Suedeze e Bujqësisë dhe Pyjeve, mbështetur nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, e mbajtur më 1-2 nëntor 2011 në sallën “Aleks Buda” të ASH-së, u organizua nga **Akad. Prof. Dr. S. Bushati**, Prof. Dr. Arsen Proko, **Akad. Prof. Dr. J. Vangjeli**, **Akad. Asoc. Prof. Dr. E. Kongjika**, Dr. Robert Nayard, **Akad. Asoc. Prof. Dr. I. Malollari**, Prof.

scientific activities, which we can summarize under the Sections.

I - SECTION OF SOCIAL AND ALBANOLOGICAL SCIENCES

1. Albania currently leads the International Association of South-Eastern Europe Studies with the **Acad. Prof. Dr. L. Omari**. Within the scientific activities AIESEE, in Warsaw it was held the International Conference **“The image of Russia in the Balkans”**, which was opened by **Acad. Prof. Dr. L. Omari**. Prof. Dr. P. Xhufi which made a speech at the conference **“From Peter the Great to Lenin: refraction of the Russian factor in the Albanian political opinion”**, which was welcomed for the research of historical findings and the quality of their performance.

2. **“Education in “turbulent times” - the Albania case in European and global context,”** a common Conference of the Academy of Sciences with the Mediterranean University of Albania AIS and Albania University (21 to 22 November 2011) with the **Acad. Assoc. Prof. Dr. A. Angjeli**. There were discussed important issues for the state of higher education in Albania.

3. The Scientific Conference **“75-th anniversary of renowned writer Ismail Kadare”**, organized on the occasion of 75th birth anniversary of Acad. Ismail Kadare, an outstanding personality and protagonist of literary and cultural developments in Albania and abroad, during a time frame more than half a century. Besides the opening from **Acad. Prof. Dr. G. Beqiraj**, Chairman of ASA and Dr. A. Bumçi, Minister of Tourism, Culture, Youth and Sports, there were held three speeches: **“The creative way of Ismail Kadare”** by Prof. Sh. Sinan, **Kadare’s Allegoric Language as the antimodel of the propaganda language of the regime”** by Prof. Dr. M. Marku and **“Aesthetic dissidence of Kadare”** held by A. Tufa.

II - SECTION OF NATURAL AND TECHNICAL SCIENCES

1. The international Conference **“Forest Policy and Reforms Towards EU Standards in Albania”**, **the first Albanian Forum on Forests**, organized by the Albanian Academy of Sciences and Royal Swedish Academy of Agriculture and Forestry, supported by the Ministry of Environment, Forests and Water Administration, held on 1-2 November 2011 in the Hall “Alex Buda” of AS organized by **Acad. Prof. Dr. S. Bushati**, Prof. Dr. Arsen Proko, **Acad. Prof. Dr. J. Vangjel**, **Acad. Assoc. Prof. Dr. E. Kongjika**, Dr. Robert Nayard, **Acad. Assoc. Prof. Dr. I. Malollari**,

Dr. Dr.h.c. Risto Pavinen, etj.

Politika e Shqipërisë për pyjet u diskutua në kuadrin e iniciativave ndërkombëtare dhe sfidave kombëtare. Qëllimi i konferencës ishte të evidentonte rëndësinë e rolit të sektorit pyjor në zhvillimin rural dhe në të gjithë zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, si dhe paraqitjen e progresit të arritur në zhvillimin e këtij sektori dhe veçanërisht, të shtronte detyrat për përmirësimin e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të qëndrueshëm.

Fjalën e hapjes së konferencës e mbajtën **Akad. Prof. Dr. Gudar Beqiraj**, kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akad. Prof. Dr. Sara von Arnold, kryetare e Akademisë Mbretërore Suedeze të Bujqësisë dhe Pyjeve. Gjithashtu uruan punimet e konferencës përfaqësues të organizatave ndërkombëtare si Banka Botërore, Projekti SIDA, që operojnë në Shqipëri për sektorin e pyjeve, si dhe nga Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Planifikimit të Territorit të Kosovës.

Z. Fatmir Mediu, ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Shqipërisë, mbajti fjalën "Objektivat e Qeverisë shqiptare për zhvillimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore në Shqipëri". Ai theksoi problemet në sektorin e pyjeve, si dhe rëndësinë e kontributit të tij në zhvillimin rural, dokumentet e rëndësishme të adoptuara nga Qeveria, përfshirjen e Shqipërisë në iniciativat ndërkombëtare për pyjet dhe proceset politike rajonale të Konferencës Ministeriale për Mbrojtjen e Pyjeve në Europë, të përcaktuara në udhëzuesit për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Në konferencë sollën përvojën e tyre në dobi të zhvillimeve progresive në Shqipëri personalitete të shquara të shkencës së pyjeve në Europë, me referatet e mëposhtme si:

- **Swedish forest policy development – from resource exploitation to sustainable forest management**, Prof. Dr. Björn Merckell;

- **Swedish Forestry Policy and Strategy support in the Balkans**, Robert Nygard (Program Officer, Sida Office Tirana) and Lennart Ljungman (Sida Senior Forestry Specialist);

- **Extension service in forestry and capacity building of the local governments** – Esbjörn Andersson Swedish Royal Academy of Agriculture and Forestry;

- **Technical Aspects of Communal Forestry in Albania** – Bob Kirmse, Senior Forest Specialist (World Bank);

- **Forest policy and legal reform in the Balkans, an overview of inclusive processes based on changing demands and reality** - Petter Campen Senior Advisor Forestry Head of Forestry Sector SNV Balkan;

- **Payment for Environmental Services - innovative financing for rural development, climate change and poverty alleviation; - a project proposal for Albania** –

Prof. Dr. Dr.h.c. Risto Pavinen, etc.

Albania's forest policy was discussed in the context of international initiatives and national challenges. The objective was to highlight the importance of the forest sector's role in rural economic development all over Albania, and to present the progress achieved in the development of this sector and particularly to present the assignments for the improvement of planning, management and stable monitoring.

The opening speech of the Conference was held by the **Acad. Prof. Dr. Gudar Beqiraj**, President of the Academy of Sciences of Albania and the Acad. Prof. Dr. Sara von Arnold, President of the Royal Swedish Academy of Agriculture and Forestry. The works of the Conference were also congratulated by representatives of International Organizations like the World Bank, SIDA Project, operating in Albania for the forestry sector, also the Ministry of Agriculture, Forestry and Territorial Planning of Kosovo.

Mr. Fatmir Mediu, Minister of Environment, Forests and Water Administration of Albania made a speech "Albanian Government objectives for the sustainable development of Natural Resources in Albania". He emphasized the problems in the forestry sector, and the importance of his contribution in the rural development, the important documents adopted by the Government, the inclusion of Albania in international initiatives on forests and regional political processes at the Ministerial Conference on the Protection of Forests in Europe set in guidelines for sustainable forest management.

In the conference those who brought their experience to the benefit of progressive developments in Albania were prominent personalities of Forest Science in Europe, with the following speeches:

- **Swedish forest policy development - from resource exploitation to sustainable forest management** - Prof. Dr. Björn Merckell;

- **Swedish Forestry Policy and Strategy support in the Balkans** - Robert NYGARD (Program Officer, Office Tirana Sida) and Lennart Ljungman (Sida Senior Forestry Specialist);

- **Extension service in Forestry and Capacity Building of the local governments** - Esbjörn Andersson Royal Swedish Academy of Agriculture and Forestry;

- **Technical Aspects of communal Forestry in Albania** - Bob Kirmse, Senior Forest Specialist (World Bank);

- **Forest policy and legal reform in the Balkans, an overview of inclusive processes based on changing demands and reality** - Petter Campen Senior Advisor Forestry Head of Forestry Sector SNV Balkan;

- **Payment for Environmental Services - innovative financing for rural development, climate change and poverty alleviation; - a project proposal for Albania** –

Andrew Mitchell, Senior Forest Specialist, the World Bank;

- **Swedish History and Global perspective on Family Forestry** - Lennart Ackzell Senior Advisor International Affairs. Fed. of Swedish Family Forest Owners;

- **Forestry Extension service and capacity building of the local governments** – Alastair Anton, Netherland Organisation for Development, Albania;

- **Forest inventory and register in Sicilia** – Arturo Oradini PANGEA, Sicilia.

Nga përfaqësues të Organizatës së Zhvillimit të Holandës (SNV), u diskutua roli i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve në nivel komunal si dhe roli përcaktues i shërbimit pyjor të ekstensionit.

Prof. Dr. Arsen Proko, drejtor i Pyjeve dhe Kullotave në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) mbajti referatin kryesor “Sektori i Pyjeve – reformat, iniciativat, sfidat dhe kontributi në zhvillimin ekonomik të vendit”, kurse specialistë të tjerë të MMPAU-së, pedagogë të Universitetit Bujqësor, anëtarë të Shoqatës së Pyjeve Komunale dhe të Përdoruesve të Kullotave, të Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) etj., paraqitën opinionet e tyre për problemet aktuale të pyjeve në vendin tonë.

Në konferencë u paraqit progresi i arritur në ngritjen e pylltarisë komunale përmes transferimit të pronës së pyjeve dhe kullotave në njësitë e qeverisjes lokale dhe përmes metodologjisë së përmirësuar të menaxhimit dhe planifikimit të pyjeve, në kuadër të Projektit të Zhvillimit të Resurseve Natyrore (NRDP).

Drejtori i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) për Shqipërinë paraqiti plan-veprimin kombëtar për sensibilizimin e publikut dhe sfidat e zbatimit të tij, kurse përfaqësues të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë theksuan rolin e Akademisë në të gjithë zhvillimin e politikave në bujqësi dhe mjedis.

Progresi i arritur për zhvillimin e kërkimit, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe reflektimet në inovacionet në sistemin edukues, ishte tema që u diskutua nga dekani i Fakultetit të Shkencave Pyjore të UBT, Prof. Dr. Vath Tabaku, si dhe nga Prof. Dr. Dr.h.c. Michael Mussong në Universitetin e Shkencave të Aplikuara, Eberswalde, Gjermani.

Ditën e dytë të aktivitetit, u organizua një udhëtim në Ulzë për të vëzhguar pyjet komunale të kësaj zone, si një risi në zhvillimin e pylltarisë shqiptare vitet e fundit, si dhe në Zonën e Mbrojtur Bregdetare të rajonit të Lezhës.

Ky aktivitet i rëndësishëm u pasqyrua dhe në faqet e shtypit suedez, duke i bërë jehonë si problemeve shkencore e me rëndësi praktike, që u shtruan në konferencë, ashtu dhe bashkëpunimit mes të dy akademive, si dhe bukurisë së natyrës shqiptare.

Në përfundim të konferencës u prezantua një *draft-*

Andrew Mitchell, Senior Forest Specialist, the World Bank;

- **Swedish History and Global perspective on Family Forestry** - Lennart Ackzell Senior Advisor International Affairs. Fed. of Swedish Family Forest Owners;

- **Forestry Extension service and capacity building of the local governments** – Alastair Anton, Netherland Organization for Development, Albania;

- **Forest inventory and register in Sicilia** – Arturo Oradini PANGEA, Sicilia.

By representatives of the Netherlands Development Organisation (SNV), it was discussed the role of sustainable management of the forests at the municipal level, and also the determining role of the forestry service of extension.

Prof. Dr. Arsen Proko, Director of Forests and Pastures in the Ministry of Environment, Forests and Water Administration (MEFWA) retained the main lecture “Forestry Sector - reforms, initiatives, challenges and contribution in the economic development of the country”, meanwhile other specialists of MEFWA, professors of Agricultural University, members of the Association of Communal Forest and of Pasture Users, of the Regional Environmental Center (REC) etc., presented their views for current problems of forests in our country.

In the conference, it was presented the progress achieved in the creation of the community forestry through the transfer of property of forests and pastures in local government units through improved methodology and planning of forest management under the Project for Natural Resources Development (NRDP).

The director of the Regional Environmental Center (REC) for Albania presented the National Action Plan to raise public awareness and challenges of its implementation, meanwhile representatives of the Albanian Academy of Sciences highlighted the role of the Academy in all development policies in agriculture and the environment.

The progress achieved on research development, technology and innovation, as well as the reflections on innovations in educational system was discussed by the Dean of the Faculty of Forest Sciences AUT, Prof. Dr. Vath Tabaku, and by Prof. Dr. Dr.h.c. Michael Mussong at the University of Applied Sciences, Eberswalde, Germany.

On the second day of activities, it was organized a trip in Ulza to observe forests of this area, as a novelty in the development of the Albanian forestry in recent years, and also the Coastal Protected Area in the region of Lezha.

This important activity was reflected in the pages of the Swedish press, echoing to scientific problems of practical importance, which were admitted to the conference, as well as to the cooperation between the two Academies, and to the beauty of Albanian nature.

At the conclusion of the Conference, it was presented

program me përcaktime, karakteristika dhe parime të Programit Kombëtar të Pyjeve, që i japin rëndësi kryesisht proceseve brenda të cilave do të zhvillohen një numër veprimtarish dhe dokumentesh drejt reformës së sektorit të pylltarisë. Pjesëmarrësit e konferencës miratuan njëzëri Deklaratën e Konferencës: **Forest Policy and Reforms in Albania towards EU Standards**, si më poshtë:

Ne, pjesëmarrësit e konferencës shkencore (me pjesëmarrës nga organizata të ndryshme dhe palët e interesuara në zhvillimin e sektorit të pyjeve në Shqipëri) "Politika e pyjeve dhe reformat në Shqipëri drejt standardeve europiane", organizuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe Akademia Mbretërore Suedeze e Bujqësisë dhe Pyjeve, me mbështetjen e Ministrisë së Mjedisit, Pylltarisë dhe Administrimit të Ujërave, mbajtur në Tiranë më 1-2 nëntor 2011:

- **jemi të bindur** se pyjet e Shqipërisë duhen administruar në mënyrë të qëndrueshme;
- **pranojmë** rolin e rëndësishëm që luajnë sektorët e tjerë, në veçanti bujqësia, energjia, uji për nxitjen e administrimit të qëndrueshëm të pyjeve (AQP);
- **theksojmë** rëndësinë kritike të pyjeve në mirëqenien, jetesën, sigurinë e ushqimit, plotësimin e nevojave për energji të popullatave lokale dhe të zhvillimit ekonomik të gjithë popullit shqiptar si për tani, ashtu edhe për brezat e ardhshëm;
- **theksojmë** rolin themelor të qeverisë për të siguruar një qeverisje të efektshme duke përfshirë ligjet, politikat dhe kapacitetet institucionale për të forcuar ligjet, për të krijuar një treg të rregullt dhe veprues, një tregti të bashkuar dhe një qeverisje të përmirësuar në sektorin e pyjeve;
- **njohim** rolin e standardeve ndërkombëtare, si kontrollat e palës së tretë (çertifikimin e pyjeve), standardet dhe rregulloret e BE;
- **shqetësohemi** për sfidat e rëndësishme lidhur me humbjet e pyjeve;
- **theksojmë** nevojën për të ruajtur tërësinë e pyjeve si sisteme ekologjike duke nxitur administrimin e qëndrueshëm të pyjeve;
- **mirëpresim** përparimin e bërë deri më sot në administrimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe arritjet domethënëse në shkallë kombëtare;
- **tërheqim vëmendjen** për një sërë alternativash të mekanizmave dhe masave në shkallë kombëtare për të mbështetur administrimin e qëndrueshëm të pyjeve;
- **nxisim përpyjekjet** kombëtare për të rritur ndërgjegjësimin e popullatës rreth rëndësisë së pyjeve dhe pjesëmarrjen e saj, si edhe për të fuqizuar arsimimin, kërkimin, zgjerimin dhe përhapjen e njohurive dhe të informacionit për të përmirësuar administrimin e pyjeve;
- **pranojmë** që kjo konferencë jep një mundësi për të shkëmbyer pikëpamje mbi mekanizmat dhe masat ndërkombëtare dhe siguron një mbështetje politike të

a *draft program* with definitions, characteristics and principles of the National Forest Programme, which give importance mainly to the processes within which there will be developed a number of documents and activities towards the reform of the forestry sector. The Conference Participants unanimously adopted the Declaration of the Conference **Forest Policy and Reforms in Albania towards EU Standards**, as follows:

We, participants of the scientific conference (with participants from different organizations and interested stakeholders in the development of forest in Albania) "The forest policy and the reforms in Albania towards European standards", organized by the Albanian Academy of Sciences and Royal Swedish Academy of Agriculture and Forestry, with support from the Ministry of Environment, Forestry and Water Management, held in Tirana on 1-2 November 2011:

- **we are confident** that Albania should manage forests in a sustainable manner;
- **we recognize** the important role played by other sectors, especially agriculture, energy, and water to promote sustainable forest management (SFM);
- **we emphasize** the critical importance of forests in welfare, livelihood, food security, the meeting of the energy needs of local populations and economic development of all the Albanian people for now and for future generations;
- **we emphasize** the fundamental role of government to ensure effective governance, including laws, policies and institutional capacities to strengthen laws to create a regular and active market, a unified trade and an improved governance in the forestry sector;
- **we recognize** the role of international standards, such as third party audits (certification of forests), EU standards and regulations;
- **we worry** about the important challenges of the loss of forests;
- **emphasize** the need to preserve the integrity of forests as ecological systems by promoting sustainable forest management;
- **we welcome** the progress made up to now in the sustainable management of forests and nationally significant achievements;
- **we draw attention** to a range of alternatives to the mechanisms and national measures to support sustainable forest management;
- **we promote** national efforts to increase the awareness of population about the importance of forests and its participation, as well as to strengthen education, research, extension and dissemination of knowledge and information to improve the management of forests;
- **we accept** that this conference provides an opportunity to exchange views on international arrangements and mechanisms and ensures political

rangut të lartë për shtjellimet e tanishme/në vijim mbi politikën e pyjeve/zhvillimin e sektorit të pyjeve;

- **nxisim** ekspertët e huaj që të lehtësojnë dhe mbështesin proceset që lidhen me pylltarinë, sidomos në përgatitjen dhe përkrahjen e Strategjisë dhe Politikës Kombëtare për Pyjet, mbështetur në përfaqshen e Programit Kombëtar për Pyjet (PKP).

Në frymën e vizionit të mësipërm, Konferenca mbështet njëzëri:

1. Krijimin sa më parë të një strategjie dhe politike të re për pyjet, mbështetur në përfaqshen pjesëmarrëse të Programit Kombëtar për Pyjet, dhe nevojën e financimit dhe të zbatimit të politikës dhe strategjisë së re menjëherë pas hartimit të tyre;

2. Përmirësimin e instrumenteve institucionale, ligjore, financiare dhe të pjesëmarrjes publike për zbatimin e politikës dhe strategjisë së re për pyjet;

3. Procesin e vazhdueshëm të decentralizimit dhe të pjesëmarrjes së popullatës në administrimin vendor të pyjeve;

4. Kalimin e pronësisë mbi pyjet tek pushteti vendor si një proces dinamik, që kërkon në vazhdimësi krijimin e kapaciteteve dhe mbështetjen e pushtetit vendor, të shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave si edhe shtrirjen e shërbimeve;

5. Pyjet nën pronësinë e shtetit në zonat e paarrtshme të larta malore, me përjashtim të Zonave të Mbrojtura, siç përcaktohen nga kategoritë e IUCN, me infrastrukturë të pamjaftueshme larg nga popullata lokale, të cilat kërkojnë investime në shkallë të gjerë dhe që mund të zhvillohen me bashkëpjesëmarrjen e sektorit privat;

6. Mbështetjen e mekanizmave nxitës për shërbimet mjedisore, të cilat do të sigurojnë përfitime financiarisht të qëndrueshme për popullatën fshatare dhe do të përkrahin investimet e nevojshme për zhvillimin e sektorit pyjor;

7. Rritjen e efikasitetit ekonomik dhe energjetik nga përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve si një përparësi;

8. Përmirësimin e bazës së të dhënave për pyjet, e inventarit të pyjeve, informatizimin e planeve të administrimit, regjistrimit të kufijve/zotërimit/pronësisë, dhe sistemet e informacionit pyjor për të dhënë ndihmesën në zhvillimin e një Sistemi të Informacionit të Administrimit Mjedisor, sipas programit INSPIRE të BE;

9. Fuqizimin e kërkimit, zhvillimit teknologjik dhe inovacionit në pylltari si një faktor i rëndësishëm për zhvillimin dhe përparimin e sektorit pyjor për të arritur standardet e BE në administrimin dhe mbikqyrjen e vazhdueshme të pyjeve;

10. Rritjen e bashkëpunimit rajonal për shkëmbimin e përvojës, zbatimin e përbashkët të programeve ndërkombëtare dhe njësimin e metodologjive, përfshirë edhe krijimin e mundshëm të një Rrjeti Pyjesh Ballkanik;

support for high-ranking current treatments / following the policy of forest / forest sector development;

- **we encourage** foreign experts to facilitate and support processes related to forestry, especially in the preparation and support of the Strategy and National Policy on Forests, based on the alignment of the National Forest Programme (NFP).

In light of the above vision, the Conference unanimously supports:

1. The establishment as soon as possible of a new strategy and policy for forests, based on participatory approach of the National Forests, and the need for funding and implementation of new policy and strategy immediately after their preparation;

2. The improvement of institutional, legal and financial instruments and public participation for the implementation of new policy and strategy for forests;

3. The ongoing process of decentralization and participation of local population in forest management;

4. The transfer of ownership of forests to local governments as a dynamic process that requires continuously the creation of the capacity and the support of local government, of associations of users of forests and pastures as well as of the expansion of services;

5. The forests owned by the state, in high mountainous inaccessible areas, with the exception of Protected Areas, as defined by the IUCN categories, with inadequate infrastructure away from the local population, which require investment in large scale and that can be developed with co-participation of the private sector;

6. The support of the incentive mechanisms for the environmental services which will provide benefits financially stable for the rural population and will support the investment needed to develop the forest sector;

7. The increasing economic efficiency and energy from sustainable use of forests as a priority;

8. The improvement of a the database on forests, forest inventory, management computerization plans, enrollment limits / possession / ownership, and forest information systems to provide assistance in developing a System of Information of the Environmental Management, under the program INSPIRE of EU;

9. The strengthening of the research, technological development and innovation in forestry as an important factor for the development and advancement of the forestry sector to reach EU standards in the management and continuous monitoring of the forest;

10. The enhancing of the regional cooperation for the exchange of experience, joint implementation of international programs and the unification of methodologies, including the possible creation of a Balkan Forest Network;

11. Rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe të njohurive si edhe transparencën me publikun, si një faktor vendimtar për qeverisjen e duhur të pyjeve;

12. Fuqizimin e arsimit të lartë duke garantuar që brezi i ardhshëm të mund të sigurojë nevojat ligjore të sektorit dhe masat për kualifikimin profesional për të pasur një fuqi të aftë punëtore.

2. Konferenca shkencore ndërkombëtare **“Biotechnological Developments”**, organizuar nga ASH në bashkëpunim me Departamentin e Bioteknologjisë, FShN, UT (Akad. Asoc. Prof. Dr. E. Kongjika, Akad. Asoc. Prof. Dr. I. Malollari, Akad. Prof. Dr. S. Bushati), më 20-21 nëntor 2011, në Akademinë e Shkencave.

Konferenca kishte për qëllim:

- Vlerësimin e zhvillimeve të bioteknologjisë në Shqipëri dhe në rajon;
- Stimulimin e bashkëpunimit midis kapaciteteve lokale në fushën e bioteknologjisë;
- Ndërtimin e bashkëpunimeve të reja midis institucioneve të vendit dhe të huaja në kuadër të projekteve të kërkimit, mësimdhënies dhe aplikimeve;
- Pasurimin e opinionit shqiptar me informacion të përditësuar mbi bioteknologjinë, aplikimet, studimet universitare dhe pasuniversitare në këtë fushë, në vendin tonë dhe në rajon;
- Diskutimin e problemeve të lidhura me çështjet e sipërpërmendura;
- Ofertën për studentët e programeve të BSc dhe MSc të Bioteknologjisë me mundësinë për pjesëmarrje në konferencë, në një sesion special;
- Fillimin e një kohe të re të bioteknologjisë së zbatuar dhe kërkimit në Shqipëri.

Në konferencë morën pjesë kërkues shqiptarë, që punojnë në vend dhe në institucione të huaja shkencore, si dhe lektorë të huaj, profesorë të shquar në fushën e bioteknologjisë nga institucione shkencore në Gjermani, Itali, Greqi, SHBA. Një eksperience pozitive është paraqitur dhe nga kërkues nga Kosova.

Konferenca u hap me fjalët e përshëndetjes nga personalitete të shkencës dhe arsimit në Shqipëri. Sekretari shkencor i Akademisë së Shkencave, Akad. Prof. Dr. S. Bushati theksoi vëmendjen e ASH-së dekadën e fundit për zhvillimet bioteknologjike në vendin tonë, duke orientuar kërkimin shkencor në disa përparësi me rëndësi të jashtëzakonshme dhe të pazëvendësueshme për zhvillimin e ekonomisë, ruajtjen e shëndetit dhe mbrojtjen e mjedisit, si përdorimi i metodave të biologjisë molekulare, bioteknologjike, të gjenetikës së zbatuar në shfrytëzimin e resurseve gjenetike shqiptare për rritjen e efektivitetit të prodhimit. Rektori i Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Dhori Kule theksoi në fjalën e tij përshëndetëse nevojën e përmirësimit të kurrikulave, të bazës

11. The increasing of the exchange of information and knowledge as well as the public transparency as a crucial factor for proper governance of forests;

12. The strengthening higher education by ensuring that future generation could provide the legal needs of the sector and vocational training measures for having a skilled labor force.

2. The International Scientific Conference **“Biotechnological Developments”** organized by AS in collaboration with the Department of Biotechnology, FNS, TU (Acad. Assoc. Prof. Dr. E. Kongjika, Acad. Assoc. Prof. Dr. I. Malollari, Acad. Prof. Dr. S. Bushati), on 20-21 November 2011, at the Academy of Sciences.

The conference goals were:

- The assessment of biotechnology developments in Albania and the region;
- The stimulating cooperation between local capacities in the field of biotechnology;
- The creation of new partnerships between institutions of national and international institutions within the projects of research, teaching and applications;
- The enrichment of the Albanian public with updated information on biotechnology, applications, and postgraduate studies in this field, in our country and the region;
- The discussion of problems associated with the above issues;
- The bid for students of BSc and MSc programs of Biotechnology of the possibility to participate in the conference in a special session;
- The launch of a new era of an applied biotechnology and research in Albania.

In the conference participated Albanian researchers, who work in the country and in other foreign scientific institutions, as well as foreign lecturers, distinguished professors in the fields of biotechnology from research institutions in Germany, Italy, Greece, and USA. A positive experience is presented even by researchers from Kosovo.

The conference was opened with words of greeting from the personalities of science and education in Albania. The Scientific Secretary of the Academy of Sciences, the Acad. Prof. Dr. S. Bushati emphasized the attention of AS the last decade for the biotechnological developments in our country, orienting scientific research on some extremely important and indispensable priorities for economic development, the safeguarding of health and environmental protection as the use of methods of molecular, biotechnological biology of the genetics implemented in the exploitation of Albanian genetic resources to increase the production efficiency. The Rector of Tirana University, Prof. Dr. Dhori Kule emphasized in his address the need to improve the curriculum, the

laboratorike dhe të kualifikimit shkencor të stafit akademik. Në konferencë përshëndetën përfaqësuesit e lektorëve të ftuar, Prof. Dr. Georgios Pilidis, president i MESAEP, Greqi, Prof. Dr. Klaus Appenroth, Universiteti 'Friedrich Schiller', Jena, Gjermani dhe Prof. Dr. Habil, Bajram Berisha, Zv. Rektori i Universitetit të Prishtinës, Kosovë.

Problemet e trajtuara në konferencë mund të konsiderohen të larmishme, të përfshira në pesë sesione të ndryshme:

(1) Bioteknologjia mjedisore; (2) bioteknologjia mjekësore; (3) bioteknologjia bujqësore; (4) bioteknologjia ushqimore, dhe (5) arsimit në bioteknologji.

Larmia e tematikës solli një pjesëmarrje të gjerë, veçanërisht të kërkuesve të rinj (110 punime nga rreth 290 kërkues, nga të cilat 10 ishin të lektorëve të huaj). Shumë punime kanë karakter të theksuar praktik të lidhur me problemet që shqetësojnë ekonominë, mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Në fushën e bioteknologjisë mjedisore u prekën problemet e pastrimit bioteknologjik dhe trajtimit të mbetjeve ujore dhe gazore, dekontaminimit të tokës, për konservimin bioteknologjik dhe karakterizimin e resurseve gjenetike dhe bioteknologjinë e resurseve edhe për energjinë e rinovueshme.

Në sesionin e bioteknologjisë mjekësore u soll eksperiencia pozitive e Qendrës së Diagnostikimit Molekular dhe Kërkimeve Gjenetike në përdorimin e metodave të ADN rekombinante në biomjekësinë shqiptare; në prodhimin e metabolitëve sekondarë nga resurset e vendit etj.

Sesioni i bioteknologjisë bujqësore paraqiti larmi të problematikës, si përdorimi i kulturave indore në konservimin e resurseve gjenetike bimore autoktone, i kulturave qelizore në prodhimin e metabolitëve sekondarë, metodat e markerëve molekulare në vlerësimin e resurseve gjenetike, mutagjeneza e induktuar, përmirësimi gjenetik etj.

Në sesionin e bioteknologjisë ushqimore u trajtuan jo vetëm metodat bioteknologjike konvencionale, por dhe përdorimi i metodave bashkëkohore, veçanërisht për problemet e sigurisë ushqimore.

Me interes u ndoq sesioni i arsimit në bioteknologji, ku paraqitën punimet e tyre studentë të Departamentit të Bioteknologjisë në FSHN të UT-së.

Duhet theksuar cilësia e lartë e punimeve shkencore të paraqitura nga lektorët e huaj dhe shqiptarë që punojnë në institucione shkencore të vendeve të zhvilluara. Problemet e trajtuara ishin me vlerë teorike dhe praktike si sensorët e bazuar në nanomaterialet për diagnostikimet dhe sigurinë (**Akad. Prof. Dr. A. Merkoçi**); vlerësimi i gjeneve të ndjeshmërisë në bimët për rezistencën ndaj streseve biotike (Prof. Dr. L. Ricciardi *et al.*); për detektimin

laboratory and scientific qualifications of academic staff. In the Conference, it was made a greeting even from the representatives of the invited lecturers, Prof. Dr. Pilidis George, President of MESAEP, Greece, Prof. Dr. Klaus Appenroth, University Friedrich Schiller', Jena, Germany and Prof. Dr. Habil, Bajram Berisha, Vice Rector of the Pristina University, Kosovo.

The issues addressed at the conference can be considered diverse, involved in five different sessions:

(1) Environmental Biotechnology, (2) Medical Biotechnology, (3) Agricultural Biotechnology, (4) Food Biotechnology, and (5) Education in Biotechnology.

The variety of topics brought a broad participation, particularly of young researchers (110 works by about 290 researchers, of which 10 were foreign lecturers). Many works have an emphasized and practical character related to the problems plaguing the economy, environment and human health.

In the field of Environmental Biotechnology, there were affected the problems of biotechnological cleaning and the treatment of water and gas waste, decontamination of soil, for the biotechnological conservation and the characterization of genetic resources and the biotechnology of the resources and for renewable energy.

In Medical Biotechnology session, it was brought the positive experience of the Centre of Diagnosis and Molecular Genetic Research on the use of DNA methods recombinant in Albanian Biomedicine; in the production of secondary metabolites from the resources of the country etc.

Agricultural Biotechnology session featured variety of problems, such as the use of tissue cultures in the conservation of indigenous plant genetic resources, of the cell cultures in the production of secondary metabolites, methods of molecular markers in the assessment of the genetic resources, induced mutagenesis, genetic improvement, etc.

At the session of Food Biotechnology there were treated not only the conventional biotechnological methods, but also the use of modern methods, especially for food security problems.

Session of Education in Biotechnology was followed with interest in biotechnology education, where students presented their work at the Department of Biotechnology in FNS of TU.

It should be emphasized the high quality of scientific papers presented by foreign and Albanian lecturers working in scientific institutions of developed countries. Problems dealt were with theoretical and practical value as the nanomaterial-based sensors for diagnostics and security (**Akad. Prof. Dr. A. Merkoçi**); evaluation of the sensitivity genes in plants for resistance to biotic stress (Prof. Dr. L. Ricciardi *et al.*) for detection

e sëmundjeve virusale në bimë (Prof. Dr. P. Saldarelli dhe F. di Serio); mbi teknologjitë omics (Dr. P. Kalaitzis); "fenotipizimi i thellë" i përgjigjes së bimëve ndaj stresit biotik dhe abiotik duke përdorur një metodë kombinuese invazive dhe joinvazive (Dr. A. Ballvora); zhvillimi i shtameve të fuqishëm novel i majave për prodhimin e niveleve të larta të terpenoidëve bimore me vlera të larta (Prof. Dr. A. Makris); një zgjidhje bioteknologjike për menaxhimin e procesimit të ujërave mbeturina të ullinjve të tavolinës (TOPW) (Prof. Dr. Georgios Pilidis) etj.

Në fund të konferencës, **Akad. Asoc. Prof. Dr. I. Malollari** paraqiti disa përfundime dhe opinione mbi punimet e konferencës, si dhe disa detyra për zhvillimet e bioteknologjisë në të ardhmen.

Në konferencë u paraqit *Book of Abstracts* me përmbledhjet e punimeve (editore **Akad. Asoc. Prof. Dr. E. Kongjika**), kurse artikujt e plotë janë dorëzuar për botim si *Proceedings* në një numër special të Buletinit të Shkencave Natyrore të FShN të UT (editore **Akad. Asoc. Prof. Dr. E. Kongjika** me një grup specialistësh nga Departamenti i Bioteknologjisë, FShN, UT).

3. Simpoziumi VII ndërkombëtar "**Biodiversiteti, ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i tij, faktorë për zhvillimin e qëndrueshëm rural**", (Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore, Fushë-Krujë; Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Universiteti Bujqësor, Departamenti i Prodhimit Shtazor dhe Shoqata ALBAGENE) (nga ASHSh – anëtare e Komitetit Shkencor **Akad. Asoc. Prof. Dr. E. Kongjika**) organizuar me rastin e Ditës Europiane të Agrobiodiversitetit – EAD, 30 Shtator 2011.

Gjithashtu, gjatë vitit 2011, akademikët kanë patur përfshirje në aktivitete recensuese për revista të ndryshme shkencore. Kështu, Akad. Asoc. Prof. Dr. N. Gruda ka recensionuar artikuj shkencorë në revista prestigjioze si *Acta Agriculturae Scandinavica, Section B - Soil & Plant Science* (1 artikull), *Acta Horticulturae* (2), *International Journal of Molecular Sciences* (1), *Plant and Soil* (1), *The Journal of Horticultural Science & Biotechnology* (1). Akad. Prof. Dr. S. Bushati ka realizuar recension të artikullit "*Impact assessment of mining activities in water quality of Jacupiranga River and tributaries, Ribeira de Iguape Valley, SP, Brazil*" të "*International Journal of Water Resources and Environmental Engineering*", www.academicjournals.org/IJWREE dhe 3 artikuj tek revista *AJNTS*; Akad. Asoc. Prof. Dr. E. Kongjika ka realizuar recension të monografisë mbi katalogimin e majave, një artikull në revistën *Acta Horticulturae* dhe artikuj në *AJNTS* dhe revista të tjera shkencore shqiptare.

VEPRIMTARITË E SEKTORËVE MBËSHTETËS

I. NJËSIA E PROJEKTEVE TË KËRKIMIT, ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK DHE INOVACIONEVE

NjPKZhl ka punuar e orientuar në përputhje me detyrat që rrjedhin nga misioni i ASh, e cila në bashkëpunim të ngushtë me seksionet, është fokusuar te konsulenca, për të rritur kapacitetet e aplikimeve në projekte të Programeve Kuadër të EU, FP7, IPA Programme, SEE-ERA.NET, TCP Programme, REC, GEF, TWAS etj., dhe tek aspektet administrative të projekteve përfshirë dhe përhapjen e rezultateve drejt biznesit apo niveleve vendimmarrëse, në përputhje me kërkesat e reja që kërkimi të shoqërohet me akte aplikative e inovative. NjPKZhl ka synuar të bëjë realitet, që produkti shkencor i Akademisë, e në përgjithësi ai i sistemit të kërkimit shkencor, të jetë pjesë integrale e arsimit të lartë duke synuar të sjellë përgjigje për prodhimin e zhvillimin e vendit. Ajo ka ideuar, aplikuar, koordinuar e menaxhuar projekte duke shërbyer edhe si nje informative e KZh, duke krijuar e zgjeruar lidhje me institucione të tjera. Duhet veçuar kontaktet e përhershme dhe shkëmbimi i informacionit me Euro Fund, WBC-INCO.NET, REC, GED, UNDP, etj., për kërkimin shkencor.

Bashkëpunimi industri-akademi përcaktohet si një ndërveprim dhe bashkëpunim i rëndësishëm midis faktorëve si biznesi, institutet dhe universitetet, në proceset e nxitjes së projekteve shumëdisiplinore përfshirë K&Zh, trajnimin dhe edukimin e burimeve

made efforts to facilitate their transfer across the academic and whole Albanian society.

Furthermore, during 2011, academics have been involved in reviewing activities for various scientific journals. Thus, Acad. Assoc. Prof. Dr. N. Gruda has reviewed scientific articles in prestigious journals *Acta Agriculturae Scandinavica, Section B - Soil & Plant Science* (1 item), *Acta Horticulturae* (2), *International Journal of Molecular Sciences* (1), *Plant and Soil* (1), *The Journal of Horticultural Science & Biotechnology* (1). Acad. Prof. Dr. S. Bushati review of the article "*Impact Assessment of mining activities in water quality of Jacupiranga River and tributaries, Ribeira de Iguape Valley, SP, Brazil*" to "*International Journal of Water Resources and Environmental Engineering*", [www.academicjournals.org / IJWREE](http://www.academicjournals.org/IJWREE) and 3 items to *AJNTS* journal, Acad. Assoc. Prof. Dr. E. Kongjika review of the monograph on the cataloging of yeast, an article in the *Acta Horticulturae* journal and articles in *AJNTS* and other scientific Albanian journals.

THE ACTIVITIES OF SUPPORT SECTORS

I. UNIT OF RESEARCH TECHNOLOGICAL DEVELOPMENT AND INNOVATION PROJECTS

URTDIP has worked and orientated in accordance with the duties that come out of the mission of AS, which in close cooperation with the sections, is focused on consultancy, to increase the capacities of applications in projects of the Framework Programmes of EU, FP7, IPA Programme, SEE-ERA.NET, TCP Programme, REC, GEF, TWAS etc., and to the administrative aspects of projects including the dissemination of results to the business or decision-making levels, in accordance with new requirements that the search is accompanied by applicative and innovative acts. URTDIP aimed to make reality, that the scientific product of the Academy and in general it is scientific research system, to be an integral part of higher education, and strive to be in response to production and development of the country. It has designed, applied, coordinated and managed projects serving as information hub of RD, creating enhanced links with other institutions. Be segregated permanent contacts and information exchange with Euro Fund, WBC-INCO.NET, REC, GED, UNDP, etc., for scientific research.

Collaboration industry-academia is defined as a significant interaction and collaboration among factors such as business, institutes and universities in the processes of promoting multidisciplinary projects including R&D, training and education of human

njerëzore dhe këmbimin e ideve dhe të informacionit.

Në bashkëpunim me seksionet, projekt-aplikimet kanë synuar në zbatimin e Strategjisë së Kërkimit, Zhvillimit Teknologjik dhe Inovacioneve, prioriteteve të vendit, të përcaktuara edhe në lidhje me prioritetet e zhvillimeve në rajon e më gjerë, si: zhvillimi shoqëror e demokratizimi i shoqërisë; përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe zhvillimi rural; ndryshimet klimatike globale; ruajtja e biodiversitetit; shëndeti e cilësia e jetës; siguria e popullsisë dhe menaxhimi i rreziqeve; sigurimi i ujit dhe i ushqimit; eficientia e energjisë; trashëgimia historike e kulturore etj.

Rezultatet në drejtim të aplikimeve me projekte e në përgatitjen e projekt-propozimeve për vitin në vazhdim e që ka nisur qysh në vitin 2011, demonstroi për tregues të mirë të veprimtarisë së NjPKZhTI-t.

Në kohë reale janë studiuar dokumente, strategji, politika kërkimi të ALLEA-s dhe akademive të mjaft vendeve të botës për eksperiencën e vlefshme në veprimtaritë e Akademisë, përfshirë tematikat e kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik dhe inovacioneve, në përshtatje me prioritetet e vendit, për t'ua propozuar seksioneve dhe për t'i përshtatur e bërë të zbatueshme në kushtet e vendit tonë.

II. DEGA EKONOMIKE

Bazuar në analizën e buxhetit të ASHSh, për vitin 2011 po paraqesim realizimin e shpenzimeve korrente dhe kapitale, duke krahasuar treguesit e buxhetit të miratuar për këtë periudhë me ata faktikë. Monitorimi është mbështetur në raportimin e Akademisë së Shkencave, për realizimin e shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2011.

Akademia e Shkencave menaxhoi fondet buxhetore të vitit 2011, në kuadër të programit *Planifikim, menaxhim dhe administrim*.

Nga ana e ASH-së janë bërë përpjekje të vazhdueshme për uljen në minimum të shpenzimeve. Në fakt, këto shpenzime kanë qenë shumë të limituara në krahasim me nevojat për një aktivitet normal të veprimtarisë së ASH-së. Në artikullin 602 - *mallra dhe shërbime* për vitin 2011, buxheti në dispozicion ka qenë 20% më i ulët krahasuar me vitin 2010. ASH, me fondet në dispozicion, e ka pasur shumë të vështirë të përballojë realizimin e detyrave të saj.

Akademia e Shkencave ka botuar një numër të konsiderueshëm veprash shkencore, monografi e periodikë (shih botimet e seksioneve), prej nga ka lindur edhe detyrimi i pagesave të honorareve për autorët e veprave shkencore (në zbatim të VKM 120 dt. 27.1.1997), të papaguara që nga viti 2007, dhe janë bërë përpjekjet maksimale për realizime edhe në këtë drejtim.

resources and exchange of ideas and information.

In cooperation with Sections, the project-applications aimed at implementing the Strategy for Research, Technological Development and Innovation, the country's priorities, as stated in connection with the priorities of development in the Region and beyond, such as social development and democratization of society; sustainable use of natural resources and rural development, global climate change, biodiversity conservation, health and quality of life; population security and management of risks, provision of food and water, energy efficiency, historic and cultural heritage.

Results in terms of applications with projects and preparation of project-proposals for next year that began in 2011, demonstrating good indicator of activity of URDIP.

In real time there have been studied documents, strategies, policy research of ALLEA and of academies of a lot of countries of the world for the valuable experience in the activities of the Academy, including themes of scientific research, technological development and innovations, in accordance to national priorities, to propose to the Sections and to adapt and to make applicable in the conditions of our country.

II. ECONOMIC DEPARTMENT

Based on the analysis of ASA budget, for 2011 we present the realization of current and capital expenses, comparing the indices of the approved budget for this period with those factual. Monitoring is based on reporting of the Academy of Sciences, to realize the expenses for the period January- December 2011.

The Academy of Sciences managed budgetary funds of the year 2011, in the framework of the program *Planning, management and administration*.

On the part of the AS have been made persistent efforts to minimize costs. In fact, these costs have been very limited in comparison with the needs for a normal activity of the activity of AS. In Article 602, *goods and services* for the year 2011, the budget available was 20% lower than in 2010. AS, with funds available, has had very difficult to afford the realization of its tasks.

The Academy of Sciences has published a considerable number of scientific works, monographs and periodicals (see publication section) from what rises also obligation of payment of honoraria of authors of scientific works (in application of DCM 120, dated 27.1.1997), which have not been paid since the year 2007, and there have been done the maximum efforts for achievements in this regard.

Gjithashtu, Akademia e Shkencave gjatë vitit 2011 ka përballuar zhvillimin e konferencave shkencore ndërkombëtare; në zhvillimin e disave prej tyre kanë kontribuar edhe organizma ndërkombëtarë në Shqipëri (SNV, BB, SOROS), për të cilat janë shpenzuar fonde për pritjen dhe akomodimin e studiuesve të huaj, pagesën e kumtesave etj.

Monitorimi i shpenzimeve të Akademisë së Shkencave, për vitin 2011, është realizuar konform ligjit dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave. Ai është mbështetur në raportimin e Akademisë së Shkencave, për realizimin e shpenzimeve për periudhën janar - dhjetor 2011 dhe paraqitet si vijon:

Shpenzimet faktike krahasuar me fondet e buxhetit për vitin 2011:

- Artikulli 600 është realizuar 84%, kjo pasi me VKM nr. 472 datë 02.07.2011 "Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore për vitin 2011" sipas pikës "1" gërma "a", një pozicion pune në organikë mbeti i paplotësuar deri në fund të vitit, gjithashtu po në bazë të këtij vendimi pika "b" dhe "c", fondi i veçantë i planifikuar nuk u përdor.

- Artikulli 601 është realizuar 85%;
- Në artikullin 602, realizimi i fondeve është 100%;
- Për artikullin 604 (shpenzime për Kosovën) sipas protokoll-marrëveshjeve të lidhura, këto fonde janë realizuar 58%;

- Në artikullin 605, - pagesat e kuotave të anëtarësisë të organizatave ndërkombëtare, në të cilat aderohet Institucioni ynë janë realizuar 38%.

- Artikulli 606 është realizuar në masën 99%;
- Në zërin 231 realizimi i fondeve është 96 %.

Shpenzimet e kryera me fondet e buxhetit të planifikuara u realizuan 92 % sipas pasqyrave të mëposhtme:

Also, the Academy of Sciences during 2011 has covered the development of scientific international conferences, including some of which have contributed the international organisms in Albania (SNV, WB, SOROS), for which funds are spent for the reception and accommodation of foreign researchers, payment of papers etc.

Monitoring of expenditure of the Academy of Sciences, in 2011, is conducted in accordance with law and directives of the Ministry of Finance. It is based on the reporting of the Academy of Sciences, to realize the expenses for the period January - December 2011 and it shows as follows:

Actual expenditures compared to budget funds for 2011:

- Article 600 is realized 84%, this after the DCM no. 472 dated 02.07.2011 "On regulation of the use of budgetary funds for 2011" under point "1" letter "a", a work in organic position remained unfilled until the end of the year, also according to this decision point "b" and "c", the special planned fund was not used.

- Article 601 is realized 85%;
- In article 602, the realization of funds is 100%;
- For article 604 (expenses for Kosovo) under the protocol concluded agreements, these funds were realized 58%;

- In article 605, - payment of membership fees to international organizations, in which adheres our Institution were realized 38%.

- Article 606 is implemented to the extent of 99%;
- In item 231 the realization of funds is 96%.

Expenses accomplished with the planned budget funds were realized 92 % according to the following reviews:

Pasqyra 1. Realizimi i buxhetit sipas zërave / Review 1. Realization of budget according to data

Në milionë lekë / In million Leks

N.	Emërtimi / <i>Indice</i>	Buxheti Vjetor / <i>Annual Budget</i> 2011	Realizimi / <i>Realization</i> 2011	%
1.	Paga / <i>Wages</i> (600)	29.5	24.718	84
2.	Sigurime shoqërore / <i>Social insurance</i> (601)	4	3.417	84
3.	Shpenzime korente / <i>Current expenses</i> (602)	14.2	14.172	100
4.	Transferta të brendshme / <i>Internal transfers</i> (604)	0.7	0.406	58
5.	Transf. me jashtë / <i>Transfers with abroad</i> (605)	0.4	0.153	38
6.	Transferime të brendshme / <i>Domestic transfers</i> (606)	31.7	31.513	99
7.	Investime / <i>Investments</i> (231)	1	0.961	96
	Totali / <i>Total</i>	81.5	75.34	92

Pasqyra 2. Niveli i realizimit të shpenzimeve në total
Reviews 2. Level of realization of expenses in total

Në milionë lekë / *In million Leks*

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti Vjetor 2011	Realizimi per vitin 2011	Ne %
1	600-601	33.5	28.135	84
2	602-606	48	47.203	98
	Totali i shpenzimeve	81.5	75.338	92

Përfundimi kryesor që nxirret nga një analizë e thjeshtë e kësaj pasqyre është se niveli i realizimit të shpenzimeve në total për vitin 2011 në krahasim me fondet e vëna në dispozicion për këtë periudhë, arriti në rreth 92 përqind, pra në një nivel të kënaqshëm.

The main conclusion that emerges from a simple analysis of this review is that the level of total expenditure implementation for 2011 in comparison with the funds available for this period, reached to about 92 percent, so in a satisfactory level.

III. DEGA E MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE PUBLIKUN

III. DEPARTMENT OF FOREIGN AND PUBLIC RELATIONS

Dega e Marrëdhënieve me Jashtë, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, ka krijuar në kohë të gjitha lehtësitë dhe procedurat për të siguruar një partneritet serioz me të gjitha institucionet ndërkombëtare dhe ato të vendit, me të cilat ASH bashkëpunon. Gjithashtu, ajo ka mbështetur pjesëmarrjen e anëtarëve të ASHSh-së në aktivitete të ndryshme si: kongrese, konferenca të akademive të Europës Qendrore e Lindore, seminare, takime protokollare, takime të ndërsjella, takime në ASH dhe marrëdhënie me mediat, për të cilat jepet informacion i hollësishëm në *Shtojcën 2*.

Department of Foreign Relations, in fulfilling its functional tasks, has created in time all the facilities and procedures to ensure a serious partnership with all international institutions and those of the country, with which AS cooperates. Also, it has supported the participation of members of ASA in various activities such as congresses, conferences of the Academies of Central and Eastern Europe, seminars, protocol meetings, mutual meetings, meetings with AS and relations with media, for which the detailed information is given in *Appendix 2*.

Gjithashtu DMJP, në përputhje me funksionet e saj, ka kontribuar në marrëdhëniet e ASH me institucionet qeverisëse (MPJ, MASH etj.), organizmat ndërkombëtarë në vend dhe me publikun.

DFPR also, in accordance with its functions, has contributed to the relationship of AS with government institutions (MFA, MES, etc.), International organisms in the country and with the public.

IV. BIBLIOTEKA SHKENCORE

IV. SCIENTIFIC LIBRARY

Një ndër hapat e rëndësishme në forcimin dhe fuqizimin e rolit të Akademisë së Shkencave ishte edhe rritja e kapaciteteve të Bibliotekës Shkencore, e cila duhej t' i përgjigjej më mirë kërkesave në drejtim të komunitetit shkencor, shoqërisë civile dhe bile dhe biznesit; ajo duhej të siguronte një shkëmbim të shpejtë cilësor e me kosto të ulët të informacionit, të produktit shkencor të akademikëve si dhe të të rejave shkencore në botë. Në realizim të këtij objekti Biblioteka Shkencore është përqendruar në tri drejtime themelore:

One of the important steps in consolidation and strengthening the role of the Academy of Sciences was the increase of capacities of Scientific Library, which had better responding to requests in terms of the scientific community, civil society and even business, it should ensure a rapid exchange of quality with low cost information, of the scientific product of academics and the scientific neps in the World. In realization of this objective Scientific Library is focused on three fundamental aspects:

- zhvillimet e reja teknologjike,
- funksionimin sa më efikas të kapaciteteve të bibliotekës

- new technological developments,
- the efficient functioning of capacities of the library and

- rritjet e kualifikimit të punonjësve në përgjigje të nivelit teknologjik të bibliotekës.

SFIDAT TEKNOLOGJIKE TË ARRITURA DHE REALIZIMI I TYRE

Ndër tri drejtimet e përmendura, zhvillimi teknologjik ka qenë një forcë lëvizëse përcaktuese ndryshimi në politikën bibliotekare. Kombinimi i mënyrës tradicionale me teknologjinë e re e ka bërë që Biblioteka Shkencore të shndërrohet në një mjedis fizik, virtual dhe tërheqës. Në një kohë të shkurtër është siguruar infrastruktura teknologjike e duhur në përshtatje të zhvillimeve të reja në fushën e informacionit, të teknologjisë së re në funksion të komunitetit shkencor:

- Së pari, duke i ofruar kërkuesit shkencor dhe specialistëve në fushat e aplikimit shkencor literaturë shkencore të nivelit të lartë, me tekst të plotë ose abstrakt, nga baza e të dhënave ProQuest. Në këtë periudhë statistikisht e klikimeve tregojnë një prirje të fortë të studiuesve në konsultimin *on-line* të revistave të specializuara, ose të titujve shkencorë, me tekst të plotë. Krahasuar me institucione të tjera kërkimore, del që nga biblioteka e Akademisë apo nga zyrat e seksioneve të saj, vjen numri më i lartë klikimeve profesionale.

- Së dyti, duke parashikuar orientim, udhëzim dhe asistencë në kërkimin shkencor për të plotësuar nevojat për informacion dhe teknologji të studentëve në kualifikimin universitar e pasuniversitar, në mastera apo doktoratura.

- Së treti, duke demonstruar ndjeshmëri në dhënien e informacionit sipas disiplinës, gradës shkencore apo objektivitetit të lexuesit.

Për të realizuar këta objektiva, salla e bibliotekës, midis të tjerave është pasuruar me infrastrukturë audiovizive: një projektor me të gjitha aksesoret e nevojshëm për aplikimin e videokonferencave, një pajisje fotokopjuese në shërbim të lexuesit, dy kompjutera të rinj; numri i posteve informatike të punës vetëm në sallën e leximit arrin kështu në 4 dhe me një lidhje *on-line* gjithë kohës, falë përkushtimit të stafit modest të projektit. Pajisjet e reja janë blerë në kuadër të projektit ERA-2011 të realizuar nga kjo bibliotekë (shih më tutje në lidhje me këtë projekt).

Në funksionimin e Bibliotekës, ajo çka shënon ndryshim është sasia e shërbimeve që ofrohen (si lexuesit drejtpërdrejt, ashtu edhe në distancë), me mbledhjen dhe klasifikimin e dokumenteve dhe burimeve elektronike që gjenerohen sipas kërkesave të lexuesve. Synimi ynë është që biblioteka të jetë kudo dhe të ndryshojë koncepti që e sheh bibliotekën tradicionale si “vend” që ofron vetëm produktet (librat, monografitë e periodikët) e saj dhe me materiale të shtypura. Padyshim që arkivat tona, koleksionet e revistave dhe të titujve akademikë, gjithë

- the increase of qualification of the employees in response to the technological level of the library.

ACHIEVED TECHNOLOGICAL CHALLENGES AND THEIR REALIZATION

Among the three directions mentioned, the technological development has been a moving force determining the change in the librarian policy. Combining the traditional way with new technology has made the Scientific Library mutate into an attractive physical and virtual environment. In a short time has been provided providing the right technological infrastructure in accordance with the new developments in the field of information, new technology in view of the scientific community:

- First, by offering scientific researcher and specialists in the fields of scientific application of scientific literature in high-level, with full text or abstract, from ProQuest database. In this period the statistics of clicks show a strong tendency of researchers to consult on-line specialized journals, or academic titles with full text. Compared with other research institutions, it appears that from the library of the Academy or from the offices of its sections, comes out the highest number of professional clicks.

- Second, by providing guidance, instruction and assistance in scientific research to meet the needs for information and technology of the students at university and postgraduate training, at Masters or PHD.

- Third, by demonstrating sensitivity to the disclosure of information according to discipline, scientific degree or objective of the reader.

To realize these objectives, the hall of the Library, among others is enriched with audio-visual infrastructure: a projector with all necessary accessories for the application of videoconferences, a photocopier equipment serving the readers, two new computers, the number of working computer posts only in the reading room, achieves at 4 and on-line connection all the time, thanks to a consecration of the modest staff: of the project. New equipment purchased under the project ERA-2011 conducted by the library (see further on relation to this project).

In operation of the Library, it is the quantity of services provided that marks the change (as direct or remote readers), the collection and classification of documents and electronic resources that are generated according to the requirements of readers. Our goal is the Library to be everywhere, and the concept to change that sees the traditional library as “place” that offers only its products (books, monographs and periodicals) and its printed materials. No doubt our archives, collections of journals and academic titles, all collected

pasuria e mbledhur, janë si gjithmonë të disponueshme për lexim me huazim ose në sallë. Bëhet fjalë për një tjetër dimension të shtuar në gamën e shërbimeve, atë elektronik. Në website-n e Akademisë në rubrikën *Biblioteka në rrjet* është krijuar një hapësirë që u kushtohet projekteve të ndryshme të bibliotekës së Akademisë me institucione të vendit ose jashtë tij. Këtu gjenden baza të dhënash on-line nga fusha të rëndësishme të shkencës.

Rishikimi i rolit të bibliotekarit, në një bibliotekë të tillë të specializuar, është shpeshherë edhe kyçi i suksesit. Pa hequr aspak dorë nga roli tradicional i bibliotekarit, është proceduar tashmë sipas konceptit që bibliotekari duhet të punojë shumë jo vetëm duke e prituri lexuesin e duke i shërbyer atij në sallë, por shpesh duke e nxitur, duke prezantuar personalisht si edhe në çdo rast që krijohet, hyrjet e reja në bibliotekë. Një nga mënyrat kryesore kanë qenë njoftimet *on-line newsletter*: Buletinët e hyrjeve të reja, libri shqip dhe libri i huaj, i shpërndarë *on-line* në rreth 200 adresa kërkuesish shkencorë dhe lexuesish, me qëllim informimin e tyre për pasurimin e BSh me tituj të rinj. Gjithashtu është shtuar edhe informimi për periodikët, me një informacion të hollësishëm rreth argumentit, autorëve dhe përmbajtjes së periodikëve në përgjithësi. Filozofia jonë është që bibliotekarët duhet të paraprijnë në dhënien e informacionit, duke pasur parasysh faktin që sot njerëzit nuk kanë shumë kohë në dispozicion dhe shpesh as edhe kompetencat e duhura për të shfrytëzuar informacionin shkencor *on-line* në mënyrë efikase. Ky është motivi që na ka shtyrë të krijojmë një bibliotekë *on-line*, me materiale të bazës ProQuest, ose dhe bazave të tjera *free* në internet, duke nxjerrë prej tij materiale sipas fushave përkatëse. Sot në kompjuterat e bibliotekës gjenden materiale nga disa fusha të rëndësishme të shkencës, Gjuhësi, Filologji, Arkitekturë, Matematikë, Shkenca të Tokës etj. Në këtë kontekst është i domosdoshëm kualifikimi i vazhdueshëm i punonjësve të BSh.

Projektet e zhvilluara në Bibliotekë kanë mbështetur pikërisht futjen e teknologjive të reja. Kështu, ndër projektet e Bibliotekës si është ai i *Bibliotekave elektronike e site-ve arbëreshe - BESA 2* për realizimin e një sistemi të integruar katalogimi dhe shfrytëzimi të fondeve, të bibliotekave të zonës së Kalabrisë dhe të Ballkanit Juglindor; në vitin 2011 u bë i mundur shfrytëzimi, përmes internetit, i katalogëve të veçantë me interes albanologjik e ballkanologjik të disa bibliotekave të specializuara të rajoneve të Siçilisë, Pulias, Shqipërisë, Malit të Zi e Maqedonisë. Katalogu elektronik i përbashkët përmban rreth 35000 rekorde duke ofruar akses të menjëhershëm të burimeve të digjitalizuara.

Projekti **"Përdorimi i literaturës shkencore on-line"** – ERA-2011, u bë i mundur në sajë të financimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Sllovenisë, zbatuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë dhe

assets, are always available for loan or reading room. It is about for another added dimension to the range of services, that electronic. In the website of Academy in the section *Library in the network*, a space has been created that consecrates to various projects of the Library of the Academy with institutions of the country or abroad. Here are on-line databases by key areas of science.

Review of the role of the librarian, in such a specialized library is often the key to success. Without giving up at the librarian's traditional role is already processed by the concept that the librarian must work hard not only waiting the reader and serving him in the hall, but often stimulating, introducing personally as in any case created, new entries in the library. One of the main ways have been reports *on-line newsletter*: Bulletins of new entries, Albanian and foreign book, distributed *on-line* at about 200 addresses of scientific researchers and readers, to inform them of enriching the SL with new titles. Information is also added to periodicals, with detailed information about the argument, authors and content of periodicals in general. Our philosophy is that librarians must precede the distribution of information, given the fact that today people do not have much time available and often not even necessary competences to use effectively on-line scientific information. This is the motive that has driven us to create a library *on-line*, by ProQuest base material, or other free bases on Internet, drawing material from its respective fields. Today at the Library computers are materials from some important areas of science: Linguistics, Philology, Architecture, Mathematics, Earth Science etc. In this context it is necessary continuous training of employees of SL.

Projects developed in the Library supported exactly the introduction of new technologies. Thus, in the projects of Library as is the *Electronic Library web site Arbëresh- BESA 2* for the realization of an integrated cataloging system and use of funds, of libraries of the area of Calabria and Southeastern Balkans, in the year 2011 was made possible the exploitation through the Internet, of special catalogs of Balkan and albanological interest of some specialized libraries of the Regions of Sicily, Puglia, Albania, Montenegro and Macedonia. Common electronic catalog contains over 35000 records providing immediate access to digitized resources.

The Project **"The use of scientific literature on-line"** - ERA-2011, was made possible thanks to funding from the Ministry of Foreign Affairs of Slovenia, applied nga the Academy of Sciences of Albania, Tirana and

Qendra Rajonale për Sistemet e Informacionit Bibliotekar dhe Sistemet e Informacionit Kërkimor, Maribor, Slloveni, nëpërmjet të cilit është bërë e mundur që të përfitohet aksesimi në një nga bazat më me peshë në literaturën *on-line* të fushave të ndryshme shkencore, në bazën e të dhënave, ProQuest; baza është e përdorshme për të gjitha bibliotekat publike në Shqipëri.

PËRFSHIRJA E STAFIT NË MËSIMDHËNIE DHE VEPRIMTARI SHKENCORE

Si sekretare shkencore e Kolegjiut të revistës *Cjuha Jonë*, tashmë organ i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Dr. M. Ymeri ka përgatitur për botim, në bashkëpunim me kolegjiutin e revistës, numrin 1-4 të vitit 2010, të kësaj reviste.

Drejtuesja e BSh, Dr. Mariana Ymeri, është edhe drejtuese e masterit të editorisë në Fakultetin e Filologjisë. Këtë vit ajo ka qenë drejtuese e dy temave vjetore të studentëve të masterit, kryesisht me argumente nga sociolinguistika dhe terminologjia.

Punonjësja e re e Bibliotekës, MSc. Sabina Prifti, e cila zëvendësoi një nga punonjëset më të vjetra të BSh, është mjaft e përkushtuar për punën dhe ka sjellë një frymë të re operativiteti në punë. Megjithëse në një shkallë të lartë kualifikimi shkencor (është duke përgatitur temën e doktoraturës në etnografi dhe ka mbajtur në këtë kontekst dy kumtesa në veprimtari shkencore kombëtare), ajo është regjistruar në shkollën dyvjeçare të kualifikimit bibliotekar, për të përftuar kompetencat e duhura në fushën e bibliografisë dhe bibliotekonomisë.

V. NJËSIA E BOTIMEVE

Njësia e Botimeve gjatë vitit 2011 ka mbështetur gjithë procesin e botimeve të Akademisë, të autorëve të ndryshëm (Akademikë) dhe të redaksive të dy seksioneve me revistat e tyre përkatëse, *Studia Albanica* për Seksionin e Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike dhe *Albanian Journal Natural and Technical Sciences (AJNTS)* për Seksionin e Shkencave Natyrore dhe Teknike. Në të njëjtën kohë, kjo njësi përgatiti edhe të gjitha materialet e konferencave që zhvilloi Akademia e Shkencave (ftesa, postera, programe, banera, libër abstraktesh dhe pas përfundimit të konferencës edhe botimin e librit të prezantimeve - proceedings book).

Për veprimtarinë, *5-th Balkan Symposium on vegetables and potatoes* (mbajtur më 9-12 tetor 2011) u botua *Book of abstracts* në anglisht; për Konferencën kombëtare të Kimisë, me temë: "*Kimia dhe zhvillimi aktual i vendit*", me rastin e Vitit Ndërkombëtar të Kimisë (mbajtur më 20 tetor 2011), u botuan: libri i përmbledhjeve (shqip) si dhe libri i punimeve (*Proceedings*), gjithashtu dhe ftesat, posterat, baneri dhe programi; për aktivitetin *International Conference*

Regional Centre for the Systems of Librarian Information and the Systems of Research Information, Maribor, Slovenia, through which it has become possible to benefit from the access in one of the bases with a lot of weight in *on-line* literature on various scientific fields, in the ProQuest Database; basis is useful for all public libraries in Albania.

INVOLVEMENT OF STAFF IN TEACHING AND SCIENTIFIC ACTIVITIES

As scientific secretary of the Collegium of the journal *Our Language*, already organ of Albanological Studies Centre, Dr. M. Ymeri has prepared for publication, in collaboration with the journal Collegium, the number 1-4 of year 2010, of this journal.

The head of SL, Dr. Mariana Ymeri, is also leader of editorial Master in the Faculty of Philology. This year she has been leader of the two annual issues of master students, mostly with arguments from sociolinguistics and terminology.

New Library employee, MSc. Sabina Prifti, which replaced one of the oldest employees of SL is very dedicated to work and has brought a new spirit of operational performance at work. Although she has a high degree of scientific training (she is preparing her doctoral topic in ethnography and in this context, she has held two papers in national scientific activity), she enrolled in two-year training school library, to acquire the necessary competencies in the field of bibliography and biblioteconomy.

V. UNIT OF PUBLICATIONS

Publications Unit in 2011 has supported the whole process of publication of the Academy, of different authors (Academic) and the editorial offices of two Sections with their respective journals, *Studia Albanica* for the Section of Social and albanological Sciences and the *Albanian Journal Natural and Technical Sciences (AJNTS)* for the Section of Natural and Technical Sciences. At the same time, this unit also prepared all the materials of conferences that developed the Academy of Sciences (invitations, posters, programs, banners, book abstracts and after the closure of conference and the publication of book presentations - proceedings book).

For the *5-th Conference of Balkan Symposium on Vegetables and Potatoes* (held on 9 to 12 October 2011) was published *Book of abstracts* in English, for the National Conference of Chemistry "*Chemistry and the current development of the country*", on the occasion of the International Year of Chemistry (held on 20 October 2011), were published: the book of summaries (in Albanian) and book of works (*Proceedings*), also invitations, posters, banner and program; for the activity

Biotechnological Developments, (mbajtur më 20-21 nëntor 2011), gjithashtu u botua në anglisht libri i abstrakteve (*Book of abstracts*), etj. Njësia e Botimeve ka mbështetur gjithashtu botimin e produkteve shkencore të disa akademikëve.

Gjatë vitit 2011 vazhdoi botimi i organeve periodike të ASH (revista shkencore):

1. *AJNTS* 30/2011
2. *AJNTS* 31/2011
3. *Studia Albanica* 1/2011
4. *Studia Albanica* 2/2011

NjB ka marrë pjesë në panairin e librit, si në: Panairin Ndërkombëtar të Shkupit (më 12-17 prill 2011), në Panairin e Librit në Prishtinë, (3-8 maj 2011); Panairin e Librit në Prishtinë (8-12 qershor 2011); Panairin e Librit në Ulqin (22-28 korrik 2011) dhe Panairin e Librit në Tiranë (9-13 nëntor 2011).

VI. FUQIZIMI I INFRASTRUKTURËS, TEKNOLOGJIVE TË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Fuqizimi i infrastrukturës, teknologjive të informacionit dhe komunikimit në Akademinë e Shkencave ka qenë një nga përparësitë kryesore. Veprimtaritë më të rëndësishme në këtë drejtim gjatë vitit 2011 kanë qenë:

Mirëmbajtja dhe rritja e kapaciteteve të infrastrukturës *hardware* dhe *software* e sistemeve të informacionit të ngritura në Akademinë e Shkencave (rrjeti kompjuterik, interneti, e-mail, administrim i bazave të të dhënave, programe dhe aplikacione, siguria, kompjuterat, printerat e rrjetit, etj.). Në këtë kuadër është përmirësuar infrastruktura e rrjetit informatik (LAN); është rritur shpejtësia lokale e shërbimit të internetit me kapacitete të dyfishuara, kapacitete këto që mundësojnë shërbime bashkëkohore në internet si video-konferenca, transferim informacioni të madhësive të mëdha etj.

Lidhur me infrastrukturën *hardware* janë rritur kapacitetet: në zyrën e arkivit dhe protokollit, duke mundësuar informatizimin e regjistrit të arkivit dhe dokumentimin e inventarëve sipas rregullave të vendosuar nga Arkivi i Shtetit; në zyrat e Bibliotekës Shkencore, duke lehtësuar procesin e katalogimit të hyrjeve të reja; në sallën e Bibliotekës Shkencore, duke shtuar asetet e sallës së kësaj biblioteke me kompjutera të rinj (të tipit desktop dhe laptop), si dhe krijimin e set-it të plotë për realizimin e konferencave të ndryshme shkencore (një videoprojektor i pajisur me kamera të inkuorporuar + presenter), duke bërë që Akademia e Shkencave të mundësojë zhvillimin e konferencave shkencore në dy salla paralele. Në të dyja sallat e konferencave, kompjuterat kanë mundësi lidhje me internetin. Kjo sallë është pasuruar gjithashtu me një

International Conference Biotechnological Developments, (held on 20-21 November 2011), it was also published the book of abstracts (*Book of abstracts - English*) etc. Also, the Publication Unit has supported the publication of scientific products of some Academics.

During the year 2011 continued the publication of periodic organs of AS (scientific journals):

1. *AJNTS* 30/2011
2. *AJNTS* 31/2011
3. *Studia Albanica* 1/2011
4. *Studia Albanica* 2/2011

UP has participated in book fairs, as in: International Fair of Skopje (12-17 April 2011), the Book Fair in Pristina, (3-8 May 2011); Pristina Book Fair (June 8 to 12 2011); Book Fair in Ulqin (22-28 July 2011) and Tirana Book Fair (9-13 November 2011).

VI. STRENGTHENING OF INFRASTRUCTURE, INFORMATION AND COMMUNICATION TECHNOLOGIES

Strengthening of infrastructure, information and communication technologies at the Academy of Sciences has been one of the major priorities. Most important activities in this regard during 2011 have been:

Maintenance and enhancement of capacities of *hardware* and *software* infrastructure of information systems set up at the Academy of Sciences (computer network, Internet, e-mail, management of databases, programs and applications, security, computers, network printers, etc.). In this context, the network computer infrastructure has been improved (LAN); local speed of Internet service has been increased with doubled capacities, capabilities that enable the modern Internet services like video-conference, information transfer to large sizes etc.

Relating to the *hardware* infrastructure, the capacities have been increased: in the office of the archive and protocol, enabling the computerization of the register of archive and the documentation of inventories according to rules established by the State Archive; in the Scientific Library offices, facilitating the process of cataloging of new entries; in the Hall of Scientific Library, adding the assets of the hall of this library with new computers (desktop and laptop type), and the creation of full set for the realization of various scientific conferences (one videoprojektor equipped with incorporated + presenter camera), making the Academy of Sciences to enable the development of scientific conferences in two parallel halls. In the two conference rooms, computers have access to the Internet. This hall is also enriched with a new

fotokopje të re të teknologjisë laser, e cila do të jetë në shërbim të lexuesve.

Në lidhje me infrastrukturën *software* janë mirëmbajtur dhe përditësuar programet e nevojshme për mbarëvajtjen e punës shkencore dhe administrative. Një aspekt tjetër është menaxhimi i punës për dizejnimin dhe mirëmbajtjen e faqes zyrtare të Akademisë së Shkencave (www.akad.edu.al) mbi një bazë të dhënash të aksesueshme komform politikës të vendosur nga Akademia e Shkencave për marrjen e informacioneve në mënyrë *on-line* nga akademikë apo universitete/institucione si dhe punonjës shkencorë që shfrytëzojnë këtë informacion.

Në kuadër të projektit ERA-2011, nga ZIT në bashkëpunim me BSh është botuar në faqen zyrtare të ASH-së gjithë informacioni rreth shërbimeve informative dhe fuqizuesve të burimeve elektronike, që mundëson ky projekt; lista e institucioneve që kanë akses në bazën e të dhënave ProQuest; institucioneve që kanë përfituar akses në këtë bazë të dhënash u është siguruar asistencë teknike lidhur me aksesimin dhe përdorimin e kësaj baze të dhënash.

Fuqizimi i Akademisë së Shkencave dhe forcimi i rolit të saj, do të ketë impakt brenda dhe jashtë vendit: në vetë Akademinë e Shkencave, në bashkësinë e komunitetit shkencor, në arsim, në të gjitha nivelet e universitetet, në edukimin shkencor të brezit të ri, në qeverisjen e vendit në spektrin politiko-ekonomik, në zhvillimin ekonomik, në shoqërinë civile, në kompanitë private, shoqëritë jofitimprurëse si dhe jashtë vendit: në rrjetin e Akademive të Europës Juglindore, InterPanelin e Akademive të Botës etj.

photocopy of the technology laser, which will be in service to readers.

Related to *software* infrastructure are maintained and updated the necessary programs for the maintenance of scientific and administrative work. Another aspect is the management of the work for designing and maintenance of the official website of the Academy of Sciences (www.akad.edu.al) based on an accessible accessible in conformity with the policy set by the Academy of Sciences to obtain information in order *on-line* from academics or universities / institutions and scientific researchers who utilize this information.

In the framework of ERA-2011 by TIC in collaboration with SL is published on the official website of AS all information about information services and the strengthening of electronic resources, that this project enables, the list of institutions that have access to the ProQuest database, institutions who have received access to this database, it has been provided technical assistance on accessing and using this database.

Strengthening of the Academy of Sciences and the strengthening of its role, will have impact inside and outside the country: at the Academy of Sciences, in the commune of the scientific community, in education at all levels and universities, in the scientific education of the new generation, in governing the country in political-economic spectrum, in the economic development, in the civil society, in the private companies, non-profit organizations as well as abroad: in the Network of Academies of South-Eastern Europe, the InterPanel of the Academies of the World etc.

PJESA E TRETË

Përparësitë e ASH-së për vitin 2012

Akademia e Shkencave e Shqipërisë shpall vitin 2012, Vitin Jubilar të Ngjarjeve të Mëdha, në të cilin do të spikatin veprimtari të koordinuara për festimin e 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe të 40-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

I. Veprimtari në kuadër të 100-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë

100-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë të Shqipërisë si një ngjarje historike kombëtare madhore, në vitin 2012 do të jetë, si në mbarë vendin, në fokusin e vlerësimit dhe të respektimit denjësisht prej Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Për karakterin e veprimtarisë së saj, kryesia e Akademisë në hartimin e projektit për nderimin e merituar të ngjarjeve të papërsëritshme, do të zhvillojë veprimtaritë kryesore të një *Akademie solemne* në fushën e botimeve dhe më gjerë të popullarizimit të saj. *Akademia solemne* është planifikuar të jetë e karakterit ndërkombëtar, me një pjesëmarrje të gjerë ku do të referojnë akademikë e profesorë albanologë të njohur në këtë fushë studimesh, studiues nga Shqipëria e Kosova, Maqedonia dhe diaspora si dhe historianë nga Gjermania, Italia e ShBA. Referuesit, nisur nga përparësia që u jep periudha 100-vjeçare, do të trajtojnë e do të përgjithësojnë rëndësinë historike të Shpalljes së Pavarësisë, vendin dhe rolin që luajti kjo ngjarje në tërë rrjedhën e historisë së kombit tonë.

Në nderim të burrit të madh Ismail Qemali, i cili vuri gurin e parë në themelet e shtetit kombëtar shqiptar, do të botohet një album kushtuar kësaj figure, përgatitur nga Akad. Kristo Frashëri.

Gjithashtu, do të botohet një numër special i revistës *Studia Albanica* me tematikë Shpalljen e Pavarësisë.

II. Veprimtari në kuadër të 40-vjetorit të themelimit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Botim për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë në 40 vitet e veprimtarisë së saj.

Objektivi:

Të mblidhen të dhënat arkivore mbi themelimin e Akademisë së Shkencave, rezultatet kryesore shkencore ndër vite si institucioni më i rëndësishëm shkencor në

PART THREE

ASA priorities for 2012

The Academy of Sciences of Albania declared 2012 the Jubilee Year of Major Events, which will show coordinated activities for the 100th-anniversary celebration of the Declaration of Independence of Albania and 40th-year anniversary of Foundation of the Academy of Sciences Albania.

I. Activities within the 100th-year anniversary of the Declaration of Independence of Albania

For 2012, this jubilee as a major national historical event will be marked in a worthy manner and will be, as throughout the country, evaluation object of well-deserved appreciation of the Albanian Academy of Sciences.

For the character of its activity, the Presidency of Academy in the compilation of the project for the merited memory of this event, will conduct the main activities in those of a *solemn Academy* in publications, and beyond the popularization of this unique event. The *solemn Academy* is planned to be of international character, with a broad participation where will refer Academics and albanological professors recognized in this field of study, researchers from Albania and Kosovo, Macedonia and the diaspora as well as historians from Germany, Italy and the U.S. The reporters, from the advantage that gives the 100th-year period will treat and will generalize the historic importance of the declaration of independence, the country and the role it played throughout the course of events in the history of our Nation.

In honor of great man Ismail Qemali, who laid the first stone in the foundations of the Albanian national state, will be published an album dedicated to this figure, prepared by the Academic Kristo Frashëri.

Also, will be published a special number of the journal *Studia Albanica* with the theme of the Declaration of Independence.

II. Activities within the 40th-year anniversary of the foundation of the Academy of Sciences of Albania

Publication for the Academy of Sciences of Albania in 40 years of its activity.

Object:

Archival data collected on the establishment of the Academy of Sciences, the main scientific results over the years as the most important scientific institution in the

vend, lidhjet ndërkombëtare të shkencëtarëve shqiptarë, pjesëmarrja në veprimtari ndërkombëtare, shkëmbimet shkencore dhe akademike, studimet shkencore të kryera nga institutet e Akademisë së Shkencave për zgjidhjen e një vargu problemesh të rëndësishme të lidhura me njohjen e natyrës e të pasurive natyrore të vendit; futjen dhe përdorimin e metodave dhe të teknologjive të përparuara në prodhimin industrial e bujqësor; përmirësimin e mbrojtjes së mjedisit e të shëndetit të popullsisë, aktiviteti i figurave të shquara të ASH, etj.

Produkti:

Realizimi i një botimi: *Akademia e Shkencave e Shqipërisë gjatë 40 viteve.*

III. Konferenca dhe Simpoziume

A. Konferencë Shkencore Ndërkombëtare mbi liqenjtë e Ohrit dhe Prespës, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë

Objektivat:

- Analiza shkencore multidisiplinore me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë (Shqipëri, Maqedoni, Greqi) për vlerësimin e studimeve për liqenët e Ohrit dhe të Prespës;

- Sensibilizimi i të gjithë vendimmarrësve politikë, të komunitetit mbarëshkencor, të shoqërisë civile e të sipërmarrësve privatë për problemet e liqeneve të Ohrit dhe të Prespës;

- Projekt-ide dhe propozime për hartimin e planeve të veprimit për zgjidhjen e problemeve të zonës së liqenit të Ohrit dhe Prespës.

Produkti:

- Mbajtja e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare për liqenët e Ohrit dhe të Prespës, në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Maqedonisë;

- Deklaratë e përbashkët dhe promemorje e studiuesve shqiptarë dhe maqedonas për hartimin e një dokumenti me rekomandime aplikative, emergjente, afatmesme e afatgjatë për zonën, e cila t'i vihet në dispozicion MMPAU-së;

- Dy botime (*Libri i Abstrakteve dhe Përmbledhje e kumtesave*);

- Ngritja e një komisioni *ad hoc* për problemet e ndryshme të zonës së liqeneve Ohër – Prespë;

- Përmirësimi i gjendjes të liqenjve të Ohrit dhe Prespës në drejtim mjedisor, kulturor dhe turistik në të gjithë arealin e liqeneve Ohër – Prespë.

B. Konferencë shkencore ndërkombëtare: “Zhvillimi i Teknologjive të Informacionit: Teoria dhe Teknologjia”

Objektivat:

- Analiza e gjendjes së zhvillimit të teknologjive të informacionit në vendin tonë vitet e fundit (sistemet e teknologjive të informacionit);

country, international connections of the Albanian scientists, participation in international activities, scientific and academic exchanges, scientific studies conducted by the institutes of the Academy of Sciences for solving a range of important issues related to recognition of the nature and of the natural resources of the country; introduction and use of methods and advanced technologies in industrial and agricultural production; improvement of environmental protection and health of the population, the activity of distinguished figures of AS, etc..

Product:

Realization of a publication: *Albanian Academy of Sciences during 40 years*

III.-Conferences and Symposiums

A. “International Scientific Conference on the lakes of Ohrid and Prespa” in cooperation with the Academy of Sciences and Arts of Macedonia.

Objects:

- Scientific multidisciplinary analysis with national and international partners (Albania, Macedonia, Greece) for the evaluation of studies of Ohrid and Prespa lakes;

- Awareness of all policy makers, of all scientific community, civil society and private entrepreneurs for the problems of Ohrid and Prespa Lake;

- Draft- proposals for the compilation of plans of action for solving the problems in the area of Ohrid and Prespa Lake.

Product:

